Raporti Vjetor

2019

© PPNEA. Të gjitha të drejtat e rezervuara.
2020

Kopertina: © Svetoslav Spasov (natureimages.eu)

Tabela e përmbajtjes

Historia e Organizatës Sonë 1
Disa Fjalë nga Drejtori Ekzekutiv 3
1. Puna për Ruajtjen e Jetës së Egër 7
1a. Programi për Rimëkëmbjen e Rrëqebullit të Ballkanit 7
1b. Foka e Mesdheut në Adriatikun Lindor 11
2. Sfidat për Ruajtjen e Shpendëve 15
2a. Jetë e Re për Kalin e Qyqes 15
2b. Rruga e Shtegtimit të Adriatikut 19
2c. "Syri i Gjelbër", Platforma Online për Raportimin e Krimeve Mjedisore 23
2d. Menaxhimi i Ligatinave dhe Ruajtja e Pelikanit Kaçurrel në Basenin e Mesdheut 24
2e. "Spring Alive", Programi i Edukimit për Shpendët Shtegtues 27
3. Ruajtja e Habitateve dhe Ekosistemeve 31
3a. Rrjeti PrespaNet dhe Projekti për Bashkëpunim Ndërkufitar në Basenin e Prespës 31
3b. Puna Jonë në Parkun Natyror Korab-Koritnik 37
3c. Toka e Kështjellave dhe Shqiponjave: Menaxhimi i Integruar i Biodiversitetit në Zonat Bregdetare në Shqipëri 42
3d. Hapja e Rrugës drejt Një Rrjeti të Qëndrueshëm Natura 2000 në Shqipëri 46
4. Programet e Edukimit Natyror dhe Nismat Ndërgjegjësuese 49
5. Avancimi Institucional 53
6. Pasqyrat Financiare 56
7. Falenderime 57

Historia e Organizatës Sonë

Qendra për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri, organizata e parë mjedisore në vendin tonë, aktualisht e ushtron aktivitetin përgjatë të gjithë territorit të Republikës së Shqipërisë. E themeluar në datën 5 qershor 1991 me një dekret special prej Akademisë së Shkencave, PPNEA e filloi aktivitetin në një periudhë tepër sfiduese. Në fillimin e viteve 90', për shkak të ndryshimeve politiko-shoqërore në vend dhe rajon, çështjet mjedisore u anashkaluan prej politikëbërësve duke u dhënë një status të margjinalizuar në programet e qeverisjes.

Pas krijimit si organizatë, PPNEA ndërtoi një reputacion aktiv me organizimin e fushatave të gjera ndërgjegjësuese dhe implementimin e projekteve me fokus ruajtjen e natyrës. Gati tre dekada pas krijimit, organizata jonë mbart një eksperiencë të gjerë në ruajtjen e natyrës dhe biodiversitetit, edukimin mjedisor, promovimin e një mënyre jetese të qëndrueshme dhe, së fundmi, në menaxhimin e burimeve natyrore.

Në dekadën e parë të ushtrimit të aktivitetit, PPNEA u karakterizua nga një rol aktiv në sferën publike nëpërmjet transmetimeve në radio, pjesëmarrjes në dokumentarë, si dhe organizimit të eventeve në natyrë. Gjithashtu, aktivitete me fokus rritjen e ndërgjegjësimit u ndërmorën në të gjithë Shqipërinë. PPNEA në tepër raste ka bashkuar organizata kombëtare e rajonale duke organizuar seminare, trajnime, workshop-e, si dhe konferenca me qëllim forcimin e rolit të shoqërisë civile dhe ngritjen e rrjeteve të bashkëpunimit, të cilat do të përbënin themelin e advokimit në të ardhmen për çështjet mjedisore. PPNEA është anëtare aktive e një numri të konsiderueshëm koalicionesh të përbëra prej organizatash mjedisore, të cilat shërbejnë si pararojë për çështjet natyrore me rëndësi në Shqipëri.

Në dekadën e dytë, PPNEA arriti të zhvillojë një profil të lartë lidhur me kërkimin shkencor dhe advokimin për politikat mjedisore. Në këtë mënyrë, fusha e aktivitetit të saj u shtri nga ndryshimi i qëndrimeve të publikut, deri në influencimin e vendimmarrjes lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Një proces i tillë ka arritur të shpërblejë, fillimisht në vitin 1999 me shpalljen e zonës së Prespës si Park Kombëtar, për të vazhduar në vitin 2008 me shpalljen e Parkut Kombëtar Shebenik-Jabllanicë. Gjithashtu, është me rëndësi të përmendët një tjetër arritje, e cila erdhi si pasojë e një procesi të gjatë vlerësimi mjedisor, hartëzimi dhe konsultimi, ku kontributi i PPNEA-s rezultoi në shpalljen e zonës Korab-Koritnik si Park Natyror në vitin 2011.

Në kuadër të ruajtjes së jetës së egër, PPNEA që prej vitit 2006 është angazhuar në një iniciativë të gjerë për ruajtjen e rrëqebullit të Ballkanit, një subspecie e rrezikuar në mënyrë kritike. Programi për Rimëkëmbjen e Rrëqebullit të Ballkanit, ka kaluar disa faza implementimi dhe aktualisht është në fazën e pestë të tij. Puna inovatore dhe metodologjia e këtij programi janë shndërruar në pika reference për monitorimin e jetës së egër dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura, jo vetëm në Shqipëri por edhe më gjerë. Në këtë dekadë, PPNEA e ka zgjeruar punën e saj pothuajse në të gjithë parqet kombëtare në Shqipëri dhe pranë zonave ndërkufitarë me Kosovën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Greqinë. Puna jonë ka qenë e konsiderueshme për të mbrojtur habitatet ligatinore dhe detare, të cilat janë shumë të rëndësishme për qindra mijëra shpendë folezues, dimërues dhe shtegtues. PPNEA po punon për shumë vite tashmë për ruajtjen dhe mbrojtjen e llojeve të rrezikuara në vend si pelikani kaçurrel apo të rrezikuara në mënyrë kritike në Shqipëri siç është kali i qyqes.

Vizioni

Të sjellim harmoni midis natyrës dhe shoqërisë njerëzore!

Misioni

Misioni i PPNEA-s është të garantojë një klimë qeverisëse dhe shoqërore ku ruajtja e trashëgimisë natyrore të jetë prioritare, nëpërmjet kërkimit shkencor rigoroz, përfshirjes së komunitetit, krijimit të partneriteteve strategjike dhe ndërveprimit të vazhdueshëm me institucionet vendimmarrëse.

Fushat e veprimit:

- Ruajtja dhe mbrojtja e llojeve me rëndësi, të rralla e të rrezikuara;
- Ruajtja dhe mbrojtja e zonave me vlera të larta të biodiversitetit;
- Studimi i jetës së egër dhe habitateve;
- Edukimi, ndërgjegjësimi dhe advokimi për çështjet e ruajtjes dhe mbrojtjes së natyrës;
- Zhvillimi institucional i organizatave mjedisore të shoqërisë civile.

PPNEA: 29 vite në ruajtjen e natyrës shqiptare

Disa fjalë nga Aleksandër Trajçe
Drejtor Ekzekutiv, PPNEA

Puna e vazhdueshme që PPNEA ka ndërmarrë, apo angazhimi i saj në çështjet mjedisore në Shqipëri që prej rënies së regjimit totalitar në vitin 1991, si dhe themelimi në po të njejtin vit, kanë ndërtuar identitetin e organizatës tonë si një strukturë që ka përjetuar vështirësitë e zhvillimit të vendit në tre dekadat e fundit dhe është rritur duke u përballur me to. Zhvillimi i PPNEA-s ka ndjekur nevojat e Shqipërisë lidhur me çështjet mjedisore dhe mbrojtjen e mjedisit. Pas rënies së regjimit totalitar dhe ndryshimit të ekonomisë nga një model i kontrolluar në një model me bazë tregun, Shqipëria ka kaluar e akoma është duke përjetuar një transformim të thellë ekonomik e social, i cili po vazhdon prej tre dekadash. Nën këtë trysni, ekzistenca e një shoqërie civile të konsoliduar, që fokusohet në çështjet e ruajtjes së natyrës, është e një rëndësie thelbësore për kundërveprimin ndaj ndikimeve negative të tranzicionit mbi trashëgiminë natyrore të vendit tonë. Që prej fillimit, PPNEA u themelua për të ngritur shqetësime rreth çështjeve mjedisore me të cilat vendi ishte duke u përballur, duke u zhvilluar më tej në një organizatë profesionale me fokus ruajtjen e natyrës. Qëllimi ynë është avancimi i ruajtjes së natyrës në vendin tonë duke ndjekur principet e kërkimit shkencor, angazhimit të palëve të interesit dhe prioritizimit të nevojave të komunitetit lokal në zonat që ne punojmë.

PPNEA ka avancuar në mënyrë domethënëse kërkimin mbi jetën e egër në Shqipëri. Ne kemi qenë të parët në prezantimin e qasjeve inovative mbi monitorimin e jetës së egër, siç janë përdorimi i kamerave-kurth (të përdorura për herë të parë nga PPNEA në vitin 2008), radio-telemetria, apo përdorimi i qasjeve të standartizuara për numërimin e shpendëve. E gjithë kjo punë është shndërruar në një themel për studimin e jetës së egër në Shqipëri, ku të dhënat e gjeneruara janë përdorur prej autoriteteve shtetërore për marrjen e vendimeve apo nismave në terren.

PPNEA

Akoma më tej, ekspertët tanë kanë rritur kapacitetet e stafit të autoriteteve kombëtare përgjegjëse për jetën e egër lidhur me metodat e monitorimit apo teknika të tjera. Këto institucione tashmë janë duke kryer në mënyrë të pavarur kërkime, duke shtuar njohuritë dhe mirëadministruar databaza mbi jetën e egër në Shqipëri.

Puna kërkimore e organizatës sonë ka qenë thelbësore për shpalljen e tre zonave të mbrojtura në Shqipëri, si Parku Kombëtar i Prespës (1999), Parku Kombëtar Shebenik-Jabllanicë (2008) dhe Parku Natyror Korab-Koritnik (2011). Aktualisht ndodhemi në fazat përfundimtare të shpalljes së malit të Munellës, fortesës së rrëqebullit të Ballkanit, si zonë e mbrojtur, një proces që është iniciuar fillimisht nga PPNEA nëpërmjet dërgimit të një propozimi zyrtar pranë autoriteteve. Ne, gjithashtu, kemi finalizuar propozimin për shpalljen e lagunës së Fllakës si zonë e mbrojtur, një territor tejet i rëndësishëm për shpendët në Shqipëri. Këto zona të mbrojtura nuk i shërbejnë vetëm ruajtjes së habitateve natyrore, por edhe komunitetit që jeton në brendësi të tyre, duke krijuar mundësi të reja për banorët lokal. PPNEA ka nxitur zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve që jetojnë në brendësi të zonave të mbrojtura, duke mundësuar përfitime të drejtpërdrejta e të matshme socio-ekonomike në formën e mikro-granteve për iniciativa të qëndrueshme dhe mënyra alternative të gjenerimit të të ardhurave. Për një periudhë 14 vjeçare PPNEA ka alokuar në formën e mikro-granteve një shumë prej 80.000 eurosh, të ardhura të cilat kanë shkuar tek organizatorët lokal apo komunitetet, me qëllim mbështetjen e mënyrave alternative të gjenerimit të të ardhurave, si ekoturizmi, prodhimi i mjaltit, kultivimi i bimëve medicinale, mbjellja e pemëve frutore, trajnimi i eko-guidave lokale, etj. Iniciativa të tilla kanë pasur një ndikim tejet pozitiv te njerëzit që kanë përfituar prej tyre, por, mbi të gjitha, kanë nxitur komunitetin e gjerë për ndjekjen e modeleve të zhvillimit të qëndrueshëm, në mënyrë që të gjenerojnë të ardhura nëpërmjet ruajtjes së mjedisit natyror.

Viti 2019 ka qenë një vit thelbësor për PPNEA-n lidhur me avancimin e aktiviteteve mbi ruajtjen e natyrës, përforcimin e partneriteteve strategjike dhe përmirësimin institucional nëpërmjet ndjekjes së objektivave afatgjatë. Në këtë raport, kemi kënaqësinë t'ju prezantojmë pjesët më të rëndësishme të punës tonë për vitin 2019. Sigurisht, asnjë prej këtyre arritjeve nuk do të ishte e mundur pa mbështetjen e donatorëve tanë, punën e palodhur të stafit, bashkëpunimin me aktorët kyç në të gjithë vendin, apo mbështetjen e komuniteteve lokale në zonat ku ne punojmë.

Ne, me dashamirësinë më të ndjerë, duam t'i falenderojmë të gjithë ata që kanë ndihmuar në punën tonë!

Akoma më tej, ne jemi të bindur se nëpërmjet vazhdimit të këtij bashkëpunimi mund të arrijmë akoma më tepër për ruajtjen e natyrës në Shqipëri.

Dr. Aleksandër Trajçe
Drejtor Ekzekutiv

Rrëqebulli i Ballkanit (Lynx lynx balcanicus) është një nënlloj i rrëqebullit euroaziatik. Ai rrezikohet në mënyrë kritike (CR) sipas Unionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN). Në Shqipëri mendohet se ekzistojnë jo më tepër se 10 individë.

© PPNEA

Puna për Ruajtjen e Jetës së Egër

Programi për Rimëkëmbjen e Rrëqebullit të Ballkanit

Ilir Shyti, Asistent i Programit

Bledi Hoxha, Menaxher i Programit

Viti 2019 ka qenë një vit i sfidave dhe i pritshmërive të larta për Programin e Rimëkëmbjes së Rrëqebullit në Shqipëri. Në mënyrë specifike, përfundimi i procesit të propozimit të Munellës si Zonë e Mbrojtur, zhvillimi i platformës së gjuetisë së qëndrueshme, përpjekjet për kapjen e rrëqebullit të Ballkanit në malin e Munellës, si dhe rasti urgjent i strehimit të rrëqebullit të Shkodrës brenda territorit të Kopshtit Zoologjik të Tiranës, kanë përbërë aktivitetet kryesore ku PPNEA është fokusuar. Gjithashtu, një punë e konsiderueshme është ndërmarrë edhe me strategjitë e tjera të projektit, si ajo e Operimit, Edukimit apo Promovimit të zonës së Munellës.

Në lidhje me procesin e shpalljes së malit të Munellës si Zonë e Mbrojtur, një hap i rëndësishëm u ndërmor në këtë vit. Pas disa takimesh të njëpasnjëshme dhe punës intensive lobuese të realizuar me institucionet vendimmarrëse në Shqipëri (Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia e Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Ambasada e Austrisë, si dhe Bashkitë e Rajonit Pukë – Mirditë),

© PPNEA

vetë Ministri z. Blendi Klosi pranoi ftesën për të marrë pjesë në takimin ndërministror të organizuar nga PPNEA në datën 9 mars 2019. Ky takim u mbajt në rajonin e Munellës, në Njësinë Administrative Gjegjan, ku Ministri deklaroi publikisht mbështetjen e tij drejt shpalljes së Munellës “Zonë e Mbrojtur”, me status “Park Kombëtar”. Ky aktivitet ka qenë tejet i rëndësishëm për arsyen se bashkoi të gjithë aktorët (institucionet kombëtare dhe vendore, shoqërinë civile dhe komunitetin lokal) përgjegjës për mbrojtjen dhe menaxhimin e natyrës në Shqipëri në një diskutim mbi iniciativën e shpalljes së malit të Munellës si “Zonë e Mbrojtur”. Aktivitetet në kuadër të kapjes së rrëqebullit në malin e Munellës kanë qenë nga më të rëndësishmet lidhur me punën kërkimore të PPNEA-s. Gjatë javës së parë të muajit shkurt 2019, një grup pune i ngritur brenda organizatës tonë ndërtoi dhe vendosi kutinë kurth në një lartësi rreth 1530m mbi nivelin e detit. Pavarësisht se kushtet klimatike nuk ishin të favorshme, stafi ynë nuk u demotivua, por qëndroi i vendosur për instalimin e kutisë kurth në shtegun e përdorur nga rrëqebulli si rrugë kalimi.

Rreth një muaj më vonë, në datën 10 mars 2019, kutia kurth u aktivizua prej një rrëqebulli, megjithatë emocioni ynë zgjati fare pak. Nëpërmjet fotografive të kapura prej kamerave kurth në afërsi të kutisë, si dhe qimeve të mbetura në pjesën e derës, ekipi ynë vërtetoi se kutia ishte aktivizuar prej rrëqebullit, por ai kishte arritur të kalojë me shpejtësi, duke mos i lënë kohë derës për t'u mbyllur. Grupi ynë ishte i pafat këtë herë, megjithatë ne besojmë së tepërmi se metoda e kutisë kurth do të jetë frtydhënëse në të ardhmen.

Në periudhën midis muajve shkurt-prill 2019, paralelisht me instalimin e kutisë kurth në malin e Munellës, u zhvillua monitorimi me kamera kurth i rrëqebullit të Ballkanit. Një numër total prej 19 kamerash kurth të tipit X-Cuddeback color Model 1279 u vendosën në rajonin e Munellës, në vendndodhje si mali i Tërbunit, Krabit, Munellës, si dhe në zonat Zepa – Kurbnesh dhe Iballë – Kryezi. Shumica e kamerave kurth u vendosën gjatë muajit shkurt dhe u lanë të aktivizuara deri në fund të muajit prill. Gjatë kësaj periudhe, kamerat u kontrolluan në mënyrë të rregullt çdo 15-20 ditë.

Gjatë të gjithë këtij procesi të vendosjes, kontrollit dhe heqjes së kamerave kurth në zonat studimore morën pjesë 4 anëtarë nga stafi i PPNEA-s. Në total, 35 foto dhe 9 video u grumbulluan nga kamerat tona, ku shumica e tyre u morën nga mali i Munellës dhe i Krabit. Midis llojeve të ndryshme, në këto foto u identifikuan edhe 2 individë të rrëqebullit të Ballkanit. Të dy këta individë ngjasonin së tepërmi me 2 prej 4 individëve të fotografuar në vitin 2017. Gjithashtu, është me rëndësi të përmendet se gjatë këtij studimi, në rajonin e Munellës u fotografua edhe një individ çakalli. Prezenca e këtij lloji në malin e Munellës u vërtetua për herë të parë nga grupi shkencor i PPNEA-s. Fotografimi i një çakalli në një lartësi prej më tepër se 900m mbi nivelin e detit, e pazakontë si nga pikëpamja e lartësisë po ashtu edhe e habitatit, ishte një surprizë për të gjithë ne.

Adresohet me sukses rasti i mbajtjes në kaptivitet të rrëqebullit në Shkodër.
Gjatë muajit Janar 2019, një rrëqebull dhe gjitarë të tjerë u konfiskuan në ambientet e restorant "Shqiponja" në qytetin e Shkodrës nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Inspekorati Mjedisor i qarkut Shkodër dhe organizata ndërkombëtare 4 Putrat. Pas konfiskimit të rrëqebullit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit vendosi që ta mbante këtë individ në Shqipëri dhe, për këtë arsye, kontaktoi PPNEA-n si organizata e vetme në Shqipëri e cila punon për mbrojtjen e kësaj specie.

Gjatë diskutimit, përfaqësuesit e Ministrisë kërkuan mbështetje financiare për ndërtimin e një strehe të re brënda territorit të Kopshtit Zoologjik në Tiranë, duke u bazuar në standartet dhe rekomandimet e ekspertëve. PPNEA e mbështeti këtë ide me shpresë se ekspozimi i rrëqebullit në ambientet e Kopshtit Zoologjik në Tiranë do të ndihmonte në rritjen e ndërgjegjësimit shoqëror lidhur me statusin e rrezikuar që ai mbart. Në datën 4 mars 2019, PPNEA së bashku me përfaqësues të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, realizoi me sukses transportin e rrëqebullit në Kopshtin Zoologjik të Tiranës, ku u strehua përkohësisht në një prej ambienteve të lira deri në ndërtimin e strehës së posaçme. Në të njejtën kohë, ekspertët filluan punën për përcaktimin e hapësirës së përshtatshme për ndërtimin e një strehe brenda territorit të kopshtit zoologjik.

Duke respektuar rekomandimet e ekspertëve dhe standartet e EAZA-s, u vendos që sipërfaqja totale e strehës së rrëqebullit të ishte 200 m2 (10m x 10m x 2.5m).

Çakalli i fotografuar nga kamerat kurth në zonën e Munelllës.

Falë kontributit të BLRP dhe UNDP, i gjithë procesi i ndërtimit zgjati rreth një muaj dhe rrëqebulli u transferua në strehën e re në mesin e muajit prill. Mbajtja e këtij individi në Shqipëri ndikoi pozitivisht në ndërgjegjësimin e institucioneve përkatëse dhe informimin e publikut mbi statusin e rrezikuar të rrëqebullit të Ballkanit.

Strategjia e edukimit është pritur me interes nga institucionet e arsimit kombëtar dhe rajonal, të cilët kanë dhënë kontributin e tyre në zbatimin e aktiviteteve të parashikuara brenda saj. BLxEduKit, programi i trajnimit dhe paketa e punës për mësuesit është zbatuar me sukses në 16 shkolla fillore në rajonin Pukë-Mirditë, ku 40 mësues dhe 395 nxënës janë trajnuar me sukses. Në mënyrë që të përfitohej një punë e standardizuar u pa i nevojshëm realizimi i disa aktiviteteve duke përdorur një kombinim metodash si, vëzhgimi i drejtpërdrejtë, shkëmbimi i përvojave të mësuesve, konkursi i vizatimit apo aktivitete reflektuese në natyrë.

Streha e re e rrëqebullit e ndërtuar brenda territorit të Kopshtit Zoologjik të Tiranës.

Foka e Mesdheut (Monachus monachus) është foka më e rrallë në të gjithë planetin, si dhe gjitari ujor më i rrezikuar i Evropës.

Foka e Mesdheut në Adriatikun Lindor

Sabina Çano, Menaxhere e Projektit

Në muajin qershor të vitit 2018, në bashkëpunim me EuroNatur, Biom, CZIP dhe MOM, PPNEA filloi implementimin e projektit "Eastern Adriatic Monk Seal" në Shqipëri, me qëllim mbrojtjen e fokës së Mesdheut (Monachus monachus).

Ky projekt 3-vjeçar ka si qëllim hapjen e rrugës për kthimin e fokës së Mesdheut pranë vijës bregdetare të Shqipërisë nëpërmjet identifikimit dhe mbrojtjes së habitateve kryesore për prezencën dhe riprodhimin e saj, si dhe informimin dhe edukimin e palëve të interesit në zonë. Në kuadër të këtij projekti u sigurua angazhimi i plotë i stafit në programe për rritjen e kapaciteteve me qëllim fillimin e menjëhershëm të koordinimit dhe implementimit të aktiviteteve në terren.

Zonat e implementimit të projektit, megjithëse përqendrohen në Parkun Kombëtar Detar Karabun - Sazan, kanë përfshirë edhe habitate të tjera potenciale përgjatë vijës sonë bregdetare. PPNEA që prej muajit prill ka nisur investigimet e shpellave ujore më të përshtatshme për strehimin dhe riprodhimin e fokës

së Mesdheut përgjatë të gjithë vijës bregdetare në Shqipëri. Foka e Mesdheut (Monachus monachus) është foka më e rrallë në të gjithë planetin, si dhe gjitari ujor më i rrezikuar i Evropës. Sipas vlerësimeve më të besueshme, aktualisht ky lloj ka një popullatë prej më pak se 700 individë, e cila kërkon masa të menjëhershme ruajtje. Kjo specie ka qenë dhe vazhdon të jetë e shpërndarë në Mesdhe, Detin e Zi dhe në Atlantikun e Veriut, megjithatë popullata e saj ka pësuar një fragmentim të lartë, duke u shpërbërë në tre - katër nënpopullata të izoluara.

Kërcënimet kryesore për mbijetesën e kësaj specie janë *degradimi i habitatit, vrasja e qëllimshme dhe ngatërrimi aksidental në mjetet e peshkimit.*

Aktivitetet kryesore të projektit për vitin 2019:

1 - Rritje kapacitetesh dhe formim rrjeti ARINT në zonë

Në datën 22 mars 2019, në Podgoricë u realizua një takim i përbashkët midis organizatave për të diskutuar mbi mënyrat dhe praktikat e duhura për implementimin e Rrjetit të Shpëtimit dhe Informimit në Shqipëri (ARINT).

Rrjeti i përbërë nga palë të ndryshme interesi do të jetë pjesë e një sërë takimesh që PPNEA do të organizojë në kuadër të vazhdimësisë së këtij projekti. Rrjeti ARINT do të shërbejë si një urë lidhëse midis PPNEA-s dhe palëve të interesit në qytetin e Vlorës dhe Sarandës, me qëllim bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacioneve në terren.

2 - Workshop teorik dhe praktik, Athinë, Greqi

Rritja e kapaciteteve shkencore të stafit të PPNEA-s për implementimin e projektit në pjesën jugore të Shqipërisë u pa si thelbësore për realizimin e objektivave të vendosura në fillim të kësaj iniciative. Stafi i PPNEA-s, në datat 19-20 maj, ka qenë pjesë e një workshopi në Athinë, ku është ndjekur një program i detajuar teorik dhe praktik. Ky program konsistontoi në njohjen e metodologjisë së investigimit të shpellave detare, karakteristikave të tyre dhe mënyrën e mbledhjes së të dhenave, duke u kombinuar, njëkohësisht, me praktikën e aplikuar në terren.

Përgjatë praktikës në terren u monitorua habitati kryesor i përshtatshëm për praninë e fokës (Monachus monachus), duke i kushtuar rëndësinë e duhur karakteristikave fizike dhe mjedisore për të kuptuar mbi tipin e morfologjisë së një shpelle detare.

Identifikimi i habitateve të qëndrueshme për pushimin dhe riprodhimin e fokës së Mesdheut

Gjatë vitit 2019 PPNEA u angazhua në mënyrë intensive me punët monitoruese të projektit. Përgjatë këtij procesi u përdorën dy metodologji pune në terren:

Investigim në terren për identifikimin e shpellave më potenciale për praninë e fokës së Mësdheut, si dhe përdorimi i GPS-it për marjen e koordinatave të tyre.

Gjatë këtij viti, prej muajit prill deri në muajin shtator, PPNEA në bashkëpunim me AdZM Vlorë realizoi 3 ekspedita monitoruese në terren. Duke u përballur me mungesën e informacionit për shpellat detare në Shqipëri, u vendos që të ndërmerej një investigim i detajuar i tyre përgjatë të gjithë vijës bregdetare, me qëllim krijimin e një harte me shpellat më të përshtatshme nga ana morfologjike për prezencen e fokës së Mesdheut. Ky aktivitet, në varësi të rezultateve përfundimtare, do të bënte të mundur zgjerimin e zonës së studimit.

Nëpërmjet një varke modeste, duke ruajtur një distance prej 40m larg vijës bregdetare, grupi ynë filloi monitorimin e shpellave detare në zonën e Karaburunit.

Në momentin e gjetjes së një shpelle, menjëherë kryej regjistrimi i saj në GPS, me qëllim përfitimin e koordinatave. Pas këtij procesi, hapi i rradhës konsistonte në analizimin e karakteristikave morfologjike, fizike apo mjedisore të shpellës.

Pyetësorët e Dimensionit Human me target grup peshkatarë, guida turistike, biznese turistike lokale, banore të zonës, etj.

Mbledhja e sa më tepër informacioneve ka qenë një pikë kyçe për vazhdimësinë e projektit. Nëpërmjet një sërë diskutimesh të realizuara me partnerët ndërkombëtarë u vendos që të hartohej një pyetësor lidhur me Dimensionin Human të iniciativës. Për hartimin e këtij pyetësori u angazhuan dy studentë të fushës së Shkencave të Natyrës, të cilët studionin në Universitetin e Tiranës dhe atë të Vlorës.

Këta studentë do të jenë në vazhdimësi pjesë e grupit ARINT, për mbrojtjen e fokës së mesdheut. PPNEA, në kuadër të implementimit sa më të drejtë të kësaj metode studimore në terren, realizoi pranë zyrave të saj një sërë takimesh konsultative. Me fillimin e implementimit të pyetësorëve në muajin shtator, deri në fund të dhjetorit, u arrit që të plotësoheshin 50 të tillë, nga ku u përfitua informacioni se foka e Mesdheut ishte parë vazhdimisht, në periudha të ndryshme kohore. Një indikator tepër i mirë për procesin e monitorimit kanë qenë fotot dhe videot e marra në periudha të ndryshme të vitit 2019, të cilat provojnë praninë e vazhdueshme të fokës së Mesdheut në bregdetin e Shqipërisë. Në vitin 2020, aktivitetet e projektit do të vazhdojnë, së bashku me zhvillimin e sesioneve ndërgjegjësuese me target grupet lokale.

Sfidat për Ruajtjen e Shpendëve

Ledi Selgjekaj, Asistente e Projektit

Mirjan Topi, Ish - Menaxher i Projektit

© Svetoslav Spasov (natureimages.eu)

Kali i Qyqes është një specie e rrezikuar në mënyrë kritike, popullata e të cilit përgjatë 30 viteve të fundit në Ballkan ka rënë me më tepër se 80%, duke u tkurrur në vetëm 50 çifte. Në Shqipëri ka më pak se 10 territore të zëna

Jetë e Re për Kalin e Qyqes

Xhemal Xherri, Menaxher i Projektit

Kali i qyqes është një specie e rrezikuar në mënyrë kritike, popullata e të cilit përgjatë 30 viteve të fundit në Ballkan ka rënë me më tepër se 80%, duke u tkurrur në vetëm 50 çifte. Sipas të dhënave nga monitorimi i fundit në Shqipëri, në zonën e luginës së Vjosës gjenden vetëm 6 çifte dhe tre individë të vetmuar të kësaj shkabe.

PPNEA e ka filluar punën për ruajtjen dhe rimëkëmbjen e popullatës së kalit të Qyqes që prej vitit 2012, duke rritur ndërgjegjësimin e përgjithshëm shoqëror, si dhe duke implementuar masa konkrete ruajtjeje në ndihmë të popullatës së kësaj shkabe të mrekullueshme. PPNEA është pjesë e 22 OJQ-ve, nga 14 shtete përgjatë Ballkanit, Lindjes së Mesme dhe Afrikës, të cilat janë duke implementuar projektin "Jetë e Re për Kalin e Qyqes" (LIFE16 NAT/BG/000874), i mbështetur nga Programi LIFE i Bashkimit Evropian në bashkëfinancim me fondacionet AG Leventis dhe MAVA. Qëllimi i projektit është të përforcojë popullatën më lindore të kalit të Qyqes në Evropë, duke ndërmarrë masa urgjente konservimi për të adresuar rreziqet më të mëdha në territoret e folezimit si dhe ato përgjatë rrugës së shtegtimit.

Përtej monitorimit të rregullt të kalit të qyqes në Shqipëri dhe ndërmarrjes së studimeve lidhur me kërcënimet që i kanosen kësaj specieje, PPNEA ka implementuar edhe masa të drejtpërdrejta ruajtjeje me qëllim rimëkëmbjen e popullatës së kalit të qyqes dhe parandalimin e rreziqeve si helmimi, elektroshoku, përplasja me struktura të ndryshme, shkatërrimi i habitatit, etj.

Ushqimi i helmuar është një prej rreziqeve kryesore për mbijetesën e kësaj specieje, prandaj një prej masave më urgjente të ndërmarra prej nesh ka qenë ndërtimi i dy stacioneve me ushqim plotësues përgjatë territoreve të folezimit të kalit të Qyqes në Shqipëri.

Të dy këto platforma, si ajo në rajonin e Kurveleshit ashtu edhe ajo e luginës së Drinos janë tërësisht operative dhe furnizohen me ushqim në mënyrë periodike. Kamera kurth e vendosur në brendësi të stacionit suplementar në luginën e Drinos monitoron gjatë gjithë kohës territorin dhe fotografon çdo lëvizje në brendësi të tij, siç janë vizitat e shpendëve. Elektroshoku është provuar që përbën një rrezik të konsiderueshëm për shpendët grabitqar. Për këtë arsye, PPNEA ka ndërmarrë izolimin e shtyllave elektrike, si një mënyrë efektive për evitimin e elektroshokut në territoret e përdorura prej kalit të qyqes. Më tepër se 30 shtylla, ose rreth 4 km rrjet elektrik, një rrezik i konsiderueshëm për shpendët, u izolua për herë të parë në Shqipëri falë organizatës tonë.

Vitin e kaluar u formalizua krijimi i rrjetit "Shpëtimtarët e Kalit të Qyqes", i përbërë prej një grupi dashamirësish të natyrës si fermerë, barinj, mësues, rojtar, inspektor, apo edhe të tjerë anëtarë të komuniteteve lokale përgjatë territoreve të folezimit të kalit të qyqes. Ky grup jep një kontribut të pashoq në mbrojtjen dhe ruajtjen e kësaj specie të mrekullueshme, duke ndihmuar në implementimin e aktiviteteve tona, apo raportimin e çfarëdo ngjarje lidhur me kalin e qyqes. Anëtarët e këtij grupi janë të parët që telefonojnë kur shikojnë të parin individ të kalit të qyqes në pranverë, kur dëshmojnë një shpend të plagosur, apo edhe kur dëshirojnë të raportojnë diçka të pazakontë ose interesante. Për më tepër, 3 tabela me informacion për projektin dhe rreth kalit të qyqes u përgatitën dhe u vendosën në rajonin e Kurveleshit.

"Një Milje për Kalin e Qyqes" është një prej fushatave ndërgjegjësuese e implemetuar pothuajse prej të gjithë partnerëve të projektit "Jetë e Re për Kalin e Qyqes", në 14 shtete të ndryshme. Në datën 13 tetor 2019, PPNEA mori pjesë në një prej aktiviteteve sportive më të mëdha në Shqipëri, ku pjesëtarë të stafit tonë vrapuan për këtë specie të rrezikuar në mënyrë kritike. Shumë nga mbështetësit tanë vrapuan duke mbajtur të veshur një bluzë në të cilën ilustrohej silueta e kalit të qyqes, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e kësaj specie dhe aksioneve konkrete që duhen ndërmarrë për rimëkëmbjen e popullatës së saj.

Një Milje për Kalin e Qyqes

Laguna Sektori - Rinia Fllakë
Zonë e rëndësishme për shpendët, në të cilën shpeshherë janë raportuar krime mjadisore.

© PPNEA

Rruga e Shtegtimit të Adriatikut

Shqipëria përbën një vend kyç për korridorin e shtegtimit përgjatë Adriatikut Lindor, e cila përdoret prej qindra mijëra shpendë gjatë rrugës së shtegtimit pranveror dhe në vjeshtë në pjesën jugore të globit. Në mes të habitateve të shumëllojshme që gjenden nëpër vende të ndryshme, shpendët gjejnë kushtet optimale për të vizituar, për të marrë energjitë nëpërmjet burimeve të ushqimit, duke kaluar të gjithë periudhën e dimrit ose duke duke zgjedhur Shqipërinë si vendin perfekt për të folezuar. Të gjitha këto procese nuk ndodhin në formë aq të paqtë sa mund t'a imagjinojmë, pasi që kërcënime të tilla si vrasja dhe tregtimi i paligjshëm i shpendëve, elektroshoku apo fenomeni i përplasjes së tyre me shtyllat elektrike, si dhe helmimi i qëllimshëm ndodhin vazhdimisht në Shqipëri. Në kuadër të këtij projekti, PPNEA ka si qëllim të luftojë këto kërcënime për shpendët dhe të krijojë rrugë shtegtimi të sigurta. Shumica e ligatinave, si pjesë e rrjetit të ligatinave që gjenden përgjatë bregdetit gëzojnë status mbrojtjeje, si Zona të Rëndësishme për Shpendët (IBA) dhe Zona Kyç të Biodiversitetit (KBA). Ndërkohë që gjiri i Lalzit, si pjesë e këtyre ligatinave, nuk gëzon status mbrojtjeje ligjore. Prandaj ndodhet nën kërcënimin e madh të gjuetisë së paligjshme, edhe pse Shqipëria është nën efektin e moratoriumit deri në vitin 2021.

Zydjon Vorpsi, Menaxher i Projektit

Gjatë vitit 2019, PPNEA ka zbatuar shumë aktivitete në drejtim të zgjidhjes së kësaj çështjeje të tilla si rritja e ndërgjegjësimit, kërkimi shkencor dhe veprime konkrete në natyrë që lidhen me advokimin dhe lobimin.

Përpjekjet për të përfshirë publikun për ndalimin e Vrajseve të Paligjshme të Shpendëve (IKB) përfaqësojnë një nga format më të targetuara për të ndaluar përfundimisht këtë fenomen, duke marrë në konsideratë se njerëzit shpesh gjenden në këto lloj situatash. Gjatë vitit 2019, këto përpjekje u përqendruan në disa drejtime duke nisur me përfshirjen në aktivitete të shkollave nga zona, postimeve në mediat sociale në linjë me fushatën ''Fluturimi për Mbijetesë'', komunikimi i drejpërdrejtë me restorantet e specializuara për gatim me llojet objekt i gjuetisë dhe organizimi i aktiviteteve në lidhje me shpendët shtegtues.

Veprime të tilla ndihmuan ekipin tonë që të lidhet akoma më tepër me komunitetin lokal dhe për t'i shpjeguar atyre dëmin që gjuetia e paligjshme shkakton drejtpërdrejtë në vendin e tyre të përbashkët. Një nga aktivitetet më të suksesshme ishte festimi i ardhjes së pranverës në kuadër të programit ''Spring Alive'', kur vullnetarë nga zona, shkollat fillore përreth dhe studentë nga Universiteti i Durrësit, iu bashkuan aksionit të pastrimit nën tematikën ''Mbro Shpendët: Bëhu Zgjidhja e Problemit me Plastikën''. Përpara fillimit të këtij aksioni, ne shpjeguam rëndësinë që ka Gjiri i Lalzit për shpendët shtegtues dhe mësuesit nga fshatrat përreth shprehën vullnetin e tyre për të ndihmuar kundrejt fenomenit të gjuetisë së paligjshme.

Kërkimi shkencor dhe veprimet në terren kanë qenë një aktivitet i vazhdueshëm përgjatë vitit, duke nisur nga muaji janar e deri në dhjetor. Për sa i përket statusit si zonë e rëndësishme për shpendët (IBA), jo të gjitha pjesët e Gjirit të Lalzit janë shpallur zonë e mbrojtur. Për të përmbushur këtë qëllim, ekipi i punës në terren i PPNEA-s ka grumbulluar të dhëna të vazhdueshme përgjatë të gjitha sezoneve, të cilat i japin akoma më shumë rëndësi kësaj zone dhe theksojnë nevojën për marrjen e një status mbrojtjeje dhe krijimin e një strukture menaxhimi.

Një nga gjetjet më të rëndësishme ishte kolonia e dallëndyshes së detit (Glareola pratincola) në zonën jugore të bregdetit. Kjo koloni u zbulua në fund të sezonit të folezimit. Edhe pse të vegjlit kishin lindur dhe disa prej tyre ishin duke mësuar fluturimin, ekipi ynë arriti të realizojë një numërim të përafërt i cili ishte midis 80-100 çifte. Nga ana tjetër, monitorimi i rregullt ndaj gjuetisë së paligjshme është realizuar në lagunë në periudhën janar-mars dhe shtator-dhjetor. Kërcënimi i gjuetisë së paligjshme dallohet mjaft lehtë në lagunë, duke arritur pikun e tij gjatë muajve nëntor, dhjetor dhe janar. Në këto sesione monitorimi janë bashkuar me ne Inspektoriati dhe Policia e Shtetit. Megjithë pengesat e krijuara prej pezullimit të inspektoriatit shtetëror për një periudhë të konsiderueshme dhe rrjedhjes së informacionit, rezultatet e monitorimit në terren mund të konsiderohen të kënaqshme për arsyen e vetme se popullata vendase ka raportuar një ulje në numrin e gjuetarëve të paligjshëm në ditët në vijim. Pas lokalizimit të të gjitha fushezave, ekipi i PPNEA-s së bashku me inspektoriatin e shtetit kanë ndërmarrë veprime të vazhdueshme për t'i shkatërruar ato. Më shumë se 25 fusheza u shkatërruan gjatë vitit 2019 në Gjirin e Lalzit.

Bashkëpunimi me institucionet e larta qeveritare përfaqëson veprimin më të rëndësishëm për të ndalur fenomenin dhe për t'i dhënë zgjidhje të gjitha çështjeve dhe problematikave që hasen në terren. Perfaqësia e OSCE në Shqipëri ka krijuar një grup konsultimi kundër krimeve mjedisore, i cili përbëhet nga organizata të shoqërisë civile. PPNEA është angazhuar si pjesë e ketij grupi, duke sjellë në vëmendje vrasjen dhe tregtinë e paligjshme të jetës së egër, përveç krimeve të tjera ndaj natyrës. Ky grup ka mundësinë që të marrë pjesë dhe të prezantojë në të njëjtën tryezë bisedimi me një grup nga institucionë kombëtare që punojnë për luftimin e krimeve mjedisore. Gjatë vitit 2019, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ndërmori një nismë për rishikimin e kufijve të zonave të mbrojtura me qëllim menaxhimin më të mirë të tyre. PPNEA së bashku me organizatat e tjera dhe ekspertë të fushës u aktivizua për të mbajtur zonat bujqësore si pjesë e zonave të mbrojtura. Përvec këtyrë përpjekjeve, ekipi ynë dërgoi një argumentim për zgjerimin e zonës së mbrotjur të Gjirit të Lalzit, duke përfshirë lagunën e Sektorit Rinia si zonë e rëndësishme për shpendët, që do t'i siguronte kësaj zone një administratë menaxhimi, dhe statusi do të ulte kërcënimin e gjuetisë së paligjshme dhe rrezikun e zhvillimit të paqëndrueshëm.
Për të forcuar betejën ndaj gjuetisë së paligjshme, PPNEA së bashku me partnerët e saj vendas dhe ndërkombëtarë kanë lobuar vazhdimisht për reformën e ligjit për gjuetinë, duke dhënë kontributin tonë për ligjin e amenduar të jetës së egër dhe atij të biodiveristetit. Kërkesa kryesore e këtij koalicioni, pjesë e të cilit është edhe PPNEA, ishte krijimi i platformës së qëndrueshme të gjuetisë, e cila është në linjë me krijimin e pritur të këshillit kombëtar të faunës mbi ligjin e amenduar të jetës së egër.

Ulja e rrezikut nga elektroshoku dhe e përplasjes me infrastrukturat e energjisë është një nismë që PPNEA ka ndërmarrë gjatë këtyre viteve me aktivitete ndërgjegjësuese dhe shumë aksione të tjera. Në kuadër të kësaj nisme, rimëkëmbja e popullatës së lejlekut në Shqipëri është një nga objektivat kryesorë. Shkaqet kryesore që kanë çuar në rënie të popullatës së këtij lloji janë humbja e habitatit, humbja e mjediseve folezuese apo dhe prishja e foleve nga njerëzit, elektroshoku, përplasja me linjat e energjisë dhe gjuetia e paligjshme (brakonazhi). Për këto arsye, PPNEA ka prodhuar 3 platforma folezuese dhe ka instaluar 2 të tilla në luginën e Drinos në bashkëpunim të ngushtë Sistemin e Operatorit të Shpërndarjes (OST). Një nga këto platforma u përdor shumë shpejt nga një cift lejlekësh, të cilët ndërtuan folenë dhe patën një sezon folezimi të suksesshëm dhe lindën 4 të vegjël duke e ruajtur popullatën e lejlkëve në Shqipëri prej 5 çifteve folezuese për vitin 2019.

Investigimet për ndikimin e helmimit të qëllimshëm kanë fillluar që në vitin 2016 nga PPNEA, duke zbatuar pyetësorë kryesisht të shtrirë në jug të rajonit, në kuadër të projektit "Jetë e Re për Kalin e qyqes" . Një studim i tillë ka vazhduar përgjatë vitit 2019, duke zgjeruar dhe zonat ku zbatohen pyetësorët. Bazuar tek ky studim, u vu re se helmimi është ende një mjet i përhapur gjerësisht në vendin tonë.

© Zydjon Vorpsi

Nga këto zona të monitoruara, 15 ishin zona të dizenjuara si Zona të Rëndësishme për Shpendët (IBA) dhe 11 prej tyre janë pjesë e rrjetit kombëtar të zonave të mbrojtura. Ekipi i PPNEA-s realizoi numërimin në Peizazhin e Mbrojtur Vjosë-Nartë, Parkun Kombëtar të Butrintit, lagunën e Orikumit, liqenin e Bufit, rezervuarin e Bulos dhe gjithashtu ka qënë e pranishme në numërimin në Liqenet e Prespës. Në total, 61 lloje të shpendëve ujorë u identifikuan gjatë 2019 në Shqipëri me një numër të përgjithshëm prej 146,395 individësh. Një iniciativë si IWC është shumë e rëndësishme dhe luan një rol të vecantë në rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e ekosistemeve të ligatinave si zona kryesore për mbijetesën e llojeve të ndryshme të shpendëve ujorë. Nga ana tjetër, ndihmon gjithashtu në motivimin dhe nxitjen e të gjithë palëve të interesuara për të kontribuar më tej në ruajtjen e natyrës në Shqipëri.

Censusi Ndërkombëtar i Shpendëve të Ujit

PPNEA për shumë vite me radhë mer pjesë në Censusin Ndërkombëtar të Shpendëve të Ujit (IWC), nismë e cila koordinohet nga Wetlands International. Censusi i shpendëve të ujit për 2019 u realizua edhe në Shqipëri, përkatësisht në datat 11-12-13 janar, ku në total u monitoruan 25 zona ligatinore, që përfshinin laguna bregdetare, liqene dhe rezervuare apo dhe këneta, plazhe ranore, etj.


© Arian Mavriqi Wildlife / Albanian Photographers

"Syri i Gjelbër", Platforma Online për Raportimin e Krimeve Mjedisore

Mjedisi natyror në Shqipëri ka qenë tabelë për kërcënime të shumëllojshme të cilat e kanë shndërruar e tjetërsuar përgjatë shekullit XX. Megjithatë, kërcënimet e 25 viteve të fundit janë ato të cilat kanë lënë më tepër shenjë me ndodhi si, pyje të prerë, ligatina të thara, kafshë të egra të vrara, toka dhe lumenj të ndotur, etj. Për këtë arsye, popullata e disa specieve të egra, siç janë shkabat, ose janë zhdukur ose janë në prag të zhdukjes. Nën dritën e kësaj situate, qeveria shqiptare krijoi dhe aprovoi ligje të cilat përkrahnin ruajtjen e natyrës, por fatkeqësisht, forca e zbatimit të tyre ende është tepër e dobët, duke rritur hendekun midis kontekstit aktual dhe objektivave ideale. Akoma më tej, qeveria shqiptare ka aprovuar dy moratoriume: moratoriumin e pyjeve (Nr.5/2016) dhe atë të gjuetisë (Nr.61/2016). Pavarësisht forces së tyre ligjore, prej monitorimeve në terren si dhe raportimeve në mediat tona sociale, rezulton se shkalla e zbatimit të tyre është tepër e ulët.

Ditë pas dite, dashamirës të natyrës dhe qytetar të përgjegjshëm raportojnë pranë mediave sociale online të PPNEA-s krime mjedisore si gjuetia e paligjshme e kafshëve, helimi, shkatërrimi i habitateve, etj.

Duke u bazuar në këtë marrëdhënie, si dhe në objektivat e moratoriumeve, PPNEA krijoi plaformën www.syrigjelber.info, një portal online i cili mbështet zbatimin e ligjit duke mbledhur raportime mbi krimet mjedisore dhe duke i deleguar ato në institucione relevante si Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Bashkitë, Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura, Inspektorati Shtetëror i Pyjeve, etj.

Ky portal është një instrument efikas për forcimin e autoritetit ligjor të moratoriumeve, i cili bashkëpunon ngushtësisht me individë të përgjegjshëm e dashamirës ndaj natyrës. Kjo platformë u krijua në shtator të vitit 2016, me suportin Ambasadës së Shteteve të Bashkuara nëpërmjet "Skemës së Granteve të Vogla të Komisionit Demokratik", në kuadër të projektit "Krijimi i një rrjeti mbikëqyrës dhe rritja e ndërgjegjësimit mjedisor në zona me vlera të larta biodiversiteti". Mirëmbajtja e këtij website-i deri në fundin e vitit 2018 u mbështet nga Ambasada e SHBA në Shqipëri, ku më pas u arrit që të financohej prej WWF Adria nëpërmjet një projekti lidhur me krimet mjedisore. Të dhënat e mbledhura nëpërmjet kësaj platforme ndihmojnë në zbatimin e të dy moratoriumeve, duke shërbyer edhe si indikatorë të zbatimit të këtyre ligjeve. Për më tepër informacion, vizitoni website-in www.syrigjelbër.info.

Përtej raportimit të krimeve mjedisore, nëpërmjet këtij portali janë adresuar edhe raste të identifikimit të kafshëve të plagosura, duke na dhënë mundësinë të ndërhyjmë pa humbur kohë. Raportimi i fundit është bërë për një shqiponjë mali (Aquila chrysaetos) të përplasur, e cila u shpëtua prej skuadrës tonë dhe, pas një muaji përkujdesje, u lirua në territoritn e vet. Që prej krijimit të këtij website-i ne kemi marrë raportime të ndryshme mbi krime mjedisore, disa prej të cilave na kanë ndihmuar në lokalizimin e rasteve të helmimit, të cilat përbëjnë kërcënimin kryesor për shkabat si dhe një nga krimet mjedisore më të përhapura në Ballkan.

© Syri i Gjelbër

© Syri i Gjelbër

Menaxhimi i Ligatinave dhe Ruajtja e Pelikanit Kaçurrel në Basenin e Mesdheut

Ligatinat Mesdhetare janë ekosisteme kyç për shumë specie, duke përfshirë edhe pelikanët, si ai kaçurrel (Pelecanus crispus), një nga llojet më të rrallë në të gjithë botën, i klasifikuar si Vulnerabël (Vu) në listën e IUCN dhe i rrezikuar në mënyrë kritike (CR) në Shqipëri, së bashku me pelikanin Rozë. Për shkak të rreziqeve si degradimi i habitatit, dranazhimi, gjuetia e paligjshme, balsamosja si dhe ndryshimet klimatike, kolonitë e pelikanëve në Shqipëri filluan që të pakësohen. Rreth 25 vjet më parë, numri i pelikanëve kaçurrel shkoi në nivelin më të ulët të dëshmuar ndonjëherë, me më pak se 30 çifte në total. Për këtë arsye, PPNEA ndërmori masa konkrete për ruajtjen e popullatës së këtij lloji në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta, si dhe popullatën e Pelikanit Rozë në Parkun Kombëtar të Prespës.

Kolonia e pelikanit në lagunën e Karavastasë ka qenë e qëndrueshme deri në vitet e para të dekadës 60', me 200-250 çifte folezuese, por për shkak të protestave e trazirave të cilat përfshinë vendin tonë, kjo popullatë u cënua deri në atë pikë sa gati u zhduk, me vetëm 19 çifte folezuese.

PPNEA nisi implementimin e programit për Menaxhimin e Ligatinave dhe Ruajtja e Pelikanit Kaçurrel në Basenin e Mesdheut në vitin 2012, ku u morën masa konkrete e të konsiderueshme drejt rimëkëmbjes së kësaj specie. Ky program kishte si qëllim ruajtjen e biodiversitetit dhe funksioneve të ekosistemit duke implementuar një menaxhim efiçent të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta, për ruajtjen e pelikanit kaçurrel si një specie emblematike.

"Menaxhimi i Ligatinave dhe Ruajtja e Pelikanit Kaçurrel në Basenin e Mesdheut" synonte mbështetjen dhe menaxhimin e tre ligatinave mbresëlënëse, të listuara si Ligatina me Rëndësi Ndërkombëtare në Konventën Ramsar, konkretisht Parku Kombëtar i Liqenit të Kërkinit në Greqi (zona pilot), Parku Kombëtar i Liqenit të Skadarit në Maqedoninë e Veriut, si dhe Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta në Shqipëri. Ky program do të arrinte synimet e përmendura më sipër, nëpërmjet këtyre objektivave:

· Rritja e njohurisë mbi pelikanin kaçurrel dhe habitatin që ai përdor, për një implementim optimal të planeve ruajtëse, specifike për secilën zonë, si dhe planeve të menaxhimit të Zonave të Mbrojtura;

· Ngritja e një rrjeti rajonal Zonash të Mbrojtura në mënyrë efektive falë përmirësimit të kapaciteteve lokale;

· Angazhimi i komuniteteve lokale në aktivitete zhvillimi të qëndrueshëm, miqësore ndaj pelikanit kaçurrel dhe habitatit të tij;

· Mediatizimi i çështjeve mjedisore dhe kërcënimeve ndaj pelikanit Kaçurrel, duke u përpjekur për të integruar këto çështje me politikat lokale dhe aktivitetet ekonomike.

Nga fundi i vitit 2018, deri në fillim te vitit 2019, përtej monitorimit të rregullt të kolonisë së pelikanit, PPNEA ndërmori masa të drejtpërdrejta me synim rimëkëmbjen e popullatës së kësaj specie, të cilat përfshinë rehabilitimin e habitatit natyror Lagunës së Karavastasë, si dhe përmirësimin e zonimit të ishullit të pelikanit nëpërmjet infrastrukturave ndihmëse, të cilat patën një impakt të menjëhershëm në uljen e shqetësimeve dhe rritjen e popullatës deri në 68 çifte folezuese.

© Xh. Xherri

Kushtet meterologjike janë shpesh një problem për habitatin natyror ku pelikani folezon, të cilat shpesh sjellin përmbytje në këto zona. Bazuar në këtë informacion ne jemi përpjekur që të rehabilitojmë habitatin natyror të kësaj specie duke vendosur në vendet e folezimit degë pemësh, trungje të vegjel, gëmusha dhe duna kripe. Si rezultat, foletë e pelikanëve u ngritën në një lartësi të sigurt, ku ata mund të zhvillonin të pashqetësuar sezonin e folezimit.

Akoma më tej, në mënyrë që të siguroheshin kushtet e përshtatshme dhe shmangia e shqetësimeve nga vizitorë si peshkatarë, turistë, fotografë, etj., në zonë u vendos një linjë me voza pluskuese shumëngjyrëshe, të cilat shërbyen për të mbrojtur këtë specie të rrezikuar në mënyrë kritike. Gjithashtu, dy tabela u vendosën përreth zonimit me qëllim që të ndalonin hyrjen e njerëzve në ishullin ku pelikanët folezojnë.

Kundrimi i shpendëve, si një prej aktiviteteve kryesore të turizmit të qëndrueshëm në Parkun Natyror Divjakë-Karavasta, është ndihmuar së tepërmi prej kullave të vrojtimit të shpendëve të ndërtuara nga PPNEA, të cilat janë mirëmbajtur, restauruar dhe pajisur me një infrastrukturë informuese mbi zonën e shpendët në brendësi të saj. Gjatë këtyre aktiviteteve, një tjetër synim për ne ishte rritja e ndërgjegjësimit për këtë tip të ri turizmi të qëndrueshëm, i bazuar në natyrë, i cili nëpërmjet kullave të vrojtimit të ndërtuara nga PPNEA rriti potencialin për të afruar akoma më shumë dashamirës të shpendëve.

© Xh. Xherri

© Xh. Xherri

“Spring Alive”, Programi i Edukimit për Shpendët Shtegtues

Klaudja Koçi, Koordinatore Kombëtare

Spring Alive është një projekt ndërkombëtar i cili synon rritjen e interesit të fëmijëve për ruajtjen e natyrës dhe njohjen e shpendëve shtegtues, me qëllim që ata të bëhen pjesë e mbrojtjes së jetës së egër, kryesisht të shpendëve. Gjithashtu, Spring Alive i inkurajon fëmijët për t’u bashkuar aktiviteteve të organizuara në 59 vende të Evropës, Azisë Qendrore dhe Afrikës, me mbështetjen e organizatës ndërkombëtare të shpendëve –BirdLife. PPNEA dhe partnerët e Spring Alive në Evropë angazhohen gjatë sezonit evropian të shtegtimit, midis muajit shkurt dhe korrik, ndërkohë që në Afrikë, fokusi vendoset në sezonin e shtegtimit Afrikan, i cili ndodh midis muajve shtator dhe janar. Nëpërmjet sesioneve të edukimit, fëmijët dhe të rriturit angazhohen në regjistrimin e vëzhgimeve të para të shpendëve shtegtues në një faqe ndërkombëtare online, e cila shfaq vizualisht edhe hartën e pranisë, apo shpërndarjes së gjashtë llojeve të shpendëve shtegtues të Spring Alive si, dallëndyshja bishtgërshërë (Hirundo rustica), dallëndyshja e brigjeve (Riparia riparia), dejka (Apus apus), lejleku (Ciconia ciconia), gargulli (Meriops apiaster) dhe qyqja (Cuculus canorus), të cilët vijnë nga vendet folezuese në Evropë dhe Azi. PPNEA i është bashkuar nismës së Spring Alive që prej vitit 2016 nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve ndërgjegjësuese, si dhe ruajtjes e mbrojtjes së shpendëve shtegtues. Një kujdes i veçantë është treguar me angazhimin e një numri të madh fëmijësh, nga shkolla dhe komunitete të ndryshme, nëpërmjet një sërë aktivitetesh të organizuara në ambiente të brendshme apo në natyrë, në territorin e zonave të mbrojtura në vend.

PPNEA, po njësoj si më parë, edhe për vitin 2019 vazhdoi traditën e zbatimit të këtij projekti. Spring Alive, duke u bazuar në një metodikë pune të ndërrimit të tematikës për çdo vit me qëllim ofrimin e një larmishmërie informacioni rreth shpendëve shtegtues, për vitin 2019 zgjodhi të implementonte tematikën "Mbrojtja e shpendëve shtegtues ndaj përplasjes me xhamat". PPNEA, së bashku me grupin e ekspertëve të shpendëve, hartuan një projekt të përbërë nga një sërë aktivitetesh të cilat u mbështetën në tre qëllime:

· Edukimin e nxënësve e të rinjve rreth natyrës dhe rritjes së ndërgjegjësimit për rëndësinë e shpendëve, kryesisht shpëndëve shtegtues që mbështet programi;

· Ndërmarrja e masave ruajtëse për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit; dhe

· Bashkëpunimi me palët e interesit dhe rrjetin e vullnetarëve me qëllim arritjen e misionit të organizatës mbi edukimin e fëmijëve apo të rinjve për mbrojtjen e shpendëve.

Aktivitetet e ndërmarra në vitin 2019:

Këtë vit projekti zbatoi një program edukimi me nxënësit e klasave fillore dhe organizoi një sërë aktivitetesh duke pasur në fokus rëndësinë e mbrojtjes së gjashtë shpendëve shtegtues të Spring Alive. Ky aktivitet kishte si qëllim përfshirjen e sa më shumë shkollave fillore nga zona të ndryshme gjeografike të Shqipërisë. Në muajin maj, PPNEA në bashkëpunim me dy shkolla 9 vjeçare në zonën e Maliqit, si "Agimi" dhe "Muharrem Veizi", formuan rrjetin e mësuesve të cilët ishin të gatshëm për të organizuar festivalin e shpendëve shtegtues me titull "Lajmëtarët e Pranverës". Si fillim, PPNEA realizoi prezantimin e njohurive rreth shpendëve shtegtues në klasa, ku nëpërmjet ndihmës së madhe të mësuesve, nxënësit u angazhuan për zhvillimin e suksesshëm të festivalit në natyrë. Me një frymë bashkëpunuese, mësuesit dhe nxënësit realizuan sëbashku ndarjen e punëve. Nxënësit u lanë të lirë për të marrë pjesë në konkursin e pikturës dhe në realizimin e maketeve lidhur me tematikën e Spring Alive.

Në këtë aktivitet u përfshinë rreth 50 nxënës të ciklit të dytë të shkollave 9 vjeçare. Festivali u zhvillua në Pyllin e Fazanëve, një zonë ideale për kundrimin e shpendëve. Nëpërmjet dylbive e ndihmës së ekspertëve të PPNEA-s, fëmijët arritën të identifikojnë disa nga shpendët e zonës, duke i mbajtur shënim edhe në fletoret e tyre. Kjo orë mësimore e zhvilluar ndryshe, mes harmonisë së natyrës dhe shpendëve, i njohu fëmijët me metodologjinë e punës së ornitologut, duke i afruar akoma më tepër me natyrën e shpendët. Po aty, ata prezantuan të gjitha punimet artistike të realizuara në kuadër të këtij festivali. Për të krijuar një atmosferë homogjene, stafi i PPNEA-s, për secilin nxënës e mësues, përgatiti trasta, bluza dhe stikera me ilustrimet identifikuese të 6 shpendëve shtegtues të SA.

Ky program edukimi arriti edhe në shkollat fillore në qytetin e Vlorës dhe të Shkodrës. Bashkëpunëtorët e PPNEA-s u angazhuan për organizimin e sesionive të edukimit brenda në klasë dhe vëzhgimin e shpendëve jashtë ambienteve të shkollës. Mësuese Aurora Piroviq, mbështeti PPNEA-n duke organizuar një orë model me nxënësit e klasës së v-të të shkollës ''Zogaj'' në qytetin e Shkodrës, duke prezantuar informacione rreth shpendëve shtegtues dhe duke angazhuar nxënësit në krijimin dhe leximin e poezive mbi këtë tematikë. Njohja me shpendët shtegtues dhe ndjekja e metodologjisë së monitorimit ngriti kureshtjen dhe dëshirën e fëmijëve për të vazhduar akoma më tej monitorimin edhe gjatë pushimeve verore, duke përditësuar, si pasojë, edhe faqen zyrtare të Spring Alive.

Ruajtja e Habitateve dhe Ekosistemeve

Rrjeti PrespaNet dhe Projekti për Bashkëpunim Ndërkufitar në Basenin e Prespës

Klaudja Koçi, Menaxhere e Projektit

Prespa, e ndarë midis tre shteteve, por e bashkuar nga një natyrë unike.

PPNEA ka punuar në rajonin e Prespës, së bashku me Shoqatën Ekologjike (MES) nga Maqedonia e Veriut dhe Shoqërinë për Mbrojtjen e Prespës (SPP) nga Greqia që prej viteve 90'. Megjithatë, në vitin 2013, këto shoqata konsoliduan bashkëpunimin e tyre të hershëm nëpërmjet nënshkrimit të një marrëveshje, duke krijuar rrjetin "PrespaNet". Ky rrjet organizatash mjedisore synon mbrojtjen e natyrës në Prespë nëpërmjet koordinimit dhe forcimit të bashkëpunimit ndërkufitar, duke bërë përpjekje për të kapërcyer hendekun e krijuar nga mungesa e bashkëpunimit institucional. PrespaNet, në vitin 2018, nisi me zbatimin e projektit të parë të përbashkët ndërkufitar "Përforcimi i ruajtjes së natyrës nën udhëheqjen e organizatave në basenin ndërkufitar të Prespës" i financuar nga PONT – Fondi i Besimit për Ohrin dhe Prespën, Fondacioni bamirës Aage V. Jensen dhe me mbështetje nga EuroNatur.

Gjatë vitit 2019, PrespaNet vazhdoi me implementimin e aktiviteteve të projektit, tashmë në fazën e dytë, e cila filloi në muajin shkurt. Në kuadër të projektit, janë zhvilluar aktivitete që lidhen me edukimin e brezit të ri, nëpërmjet programeve të edukimit natyror për fëmijë dhe përfshirjes së të rinjve në shkolla verore ndërkufitare. Këto programe kanë si synim shpërndarjen e informacioneve mbi territorin e basenit, nëpërmjet përdorimit të materialeve të komunikimit të përgatitura bashkarisht, të cilat janë tepër efikase në rritjen e ndërgjegjësimit për çështjet e ruajtjes së natyrës dhe promovimin e punës së PrespaNet në territorin e basenit. Gjithashtu, PrespaNet ka ndërmarrë monitorime dhe studime mbi jetën e egër në Prespë, në veçanti për gjitarët e mëdhenj; Akoma më tej, janë hartëzuar habitatet dhe vegjetacioni përgjatë brigjeve të liqeneve të Prespës sipas procesit të Natura 2000. Të gjitha këto aktivitete kanë si qëllim të kontribuojnë në përmbushjen e objektivave të projektit.

Parku Ndërkufitar i Prespës, një zonë e ndarë midis Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë
-
Ishulli i Maligradit

© PPNEA

Hartëzimi dhe vlerësimi i habitateve përreth liqeneve të Prespës, duke u bazuar në standartet e Natura 2000, u zbatua për herë të parë në anën shqiptare të Prespës. Një ekip ekspertësh nga SPP dhe PPNEA, së bashku me vullnetarë nga Universiteti Fan S. Noli në Korçë, përgjatë gjithë verës dhe fillimit të vjeshtës 2019, kryen ekspeditat në terren për hartëzimin e habitateve të rëndësishme. Rezultatet e punës dhe harta e realizuar për pjesën shqiptare do të plotësojë hartën e habitateve të rëndësishme që gjenden përgjatë brigjeve në të tre anët e liqeneve të Prespës, rezultatet e të cilave u mundësuan nga i njëjti studim i kryer në dy anët e tjera të basenit. Rezultatet e përgjithshme të këtij studimi do të përdoren për të implementuar masa pilot për ruajtjen e këtyre habitateve gjatë vitit 2020-2021. Gjitarët e mëdhenj, duke qenë një pjesë e pandashme, por njëkohësisht më pak e dukshme e biodiversitetit në rajon, shtojnë kuriozitetin për të zbuluar më tepër për ta, në mënyrë që të ndërmerren masa konservuese për ruajtjen e popullatave të tyre. Për këtë arsye, studimi i tyre në rajonin e Prespës vazhdon të ndërmerret për të dytin vit rradhazi. Nëpërmjet kamerave kurth të vendosura në rajon gjatë periudhës së vjeshtës 2019, u përfitua një larmishmëri informacioni rreth llojeve të kafshëve që jetojnë në territorin e basenit ndërkufitar të Prespës. Në punën me gjitarët e mëdhenj, PrespaNet po zhvillon edhe një studim më të specifikuar, i cili fokusohet në përfitimin e njohurisë rreth dietës së ariut të murrmë, nëpërmjet mbledhjes së kampioneve nga feçet e tij, të cilat analizohen në laboratorë të posaçëm jashtë Shqipërisë. Gjithashtu, këto kampione pritet të ndihmojnë edhe studimin gjenetik (ADN-në), për të vlerësuar numrin e popullatës së ariut të murrmë në të gjithë basenin e Prespës. Duke qenë se Prespa është një zonë e banuar në të tre anët e saj, komunitetet lokale jetojnë në afërsi të jetës së egër. Për këtë arsye, konfliktet midis njeriut dhe jetës së egër janë të pranishme edhe këtu. Me qëllim identifikimin e këtyre konflikteve në Prespë, u zhvillua një studim për të mbledhur informacione rreth dëmeve të shkaktuara tek fermerët nga jeta e egër që ndodhet në zonë.

© PPNEA

© PPNEA

Këto të dhëna do të përdoren për të ndërmarrë masa zbutëse në të ardhmen. Ndërgjegjësimi për rëndësinë e ruajtjes së natyrës duhet të udhëhiqet nga ata që kanë energjinë dhe dashamirësinë më të madhe për të mësuar rreth saj, të rinjtë. Shkollat verore ndërkufitare organizohen çdo vit nga PrespaNet. Pas shkollës verore ndërkufitare që u organizua në vitin 2018 nga PPNEA në Prespë, në vitin 2019 MES organizoi Kampin Veror në Parkun Kombëtar të Pelisterit. Ky kamp, si çdo vit, mblodhi studentë dhe studiues të rinj nga të tre shtetet që ndajnë basenin e Prespës, për të mësuar rreth metodave të monitorimit dhe studimit të aspekteve të ndryshme të natyrës dhe biodiversitetit, duke punuar së bashku në terren me ekspertë të fushave përkatëse. Ndarja e informacionit dhe promovimi i punës së PrespaNet është pjesë e pandashme dhe tepër e rëndësishme e rrjetit tonë. Informimi i publikut të gjerë dhe përcjellja e informacionit edhe tek ajo pjesë e popullsisë e cila nuk ka mundësi ta ndjekë punën tonë nëpërmjet teknologjisë, na krijon hapësira të tjera bashkëpunimi me banorët vendas, të cilët janë partnerët më të mirë që PPNEA dhe PrespaNet mund të ketë. Nëpërmjet buletineve informative, fletëpalosjeve dhe video-ve, rrjeti ynë promovon dhe përcjell informacione rreth zhvillimeve të fundit nga puna e PrespaNet. Një pjesë e rëndësishme për punën tonë është përfshirja dhe krijimi i rrjetit të vullnetarëve. Duke i ofruar mundësi të rinjve për t'u përfshirë në aktivitetet e projektit, si dhe të vetë PPNEA-s, ne përpiqemi të krijojmë një grup specialistësh të rinj, të cilët kanë dëshirë dhe vullnet për të mësuar dhe për t'a përcjellë më tej këtë eksperiencë. Ndarja e njohurive dhe eksperiencave me vullnetarët përbën një përfitim të dyanshëm, i cili ndihmon në implementimin e plotë të aktiviteteve tona, duke i shërbyer njëkohësisht edhe rritjes profesionale të të rinjve. Nëpërmjet mbështetjes së PONT dhe fondacionit Aage V. Jensen, PPNEA hapi zyrën e saj lokale në Parkun Kombëtar të Prespës, e cila premton për një angazhim afatgjatë dhe të dedikuar në rajon.

© PPNEA

© PPNEA

Censusi i Pelikanit

Pelikani, një lloj flamur që folezon në anën Greke të liqeneve të Prespës, është monitoruar në nivel ndërkufitar prej partnerëve të PrespaNet, deri në vitin 2018, kur u grumbulluan mjaftuehsëm të dhëna. Në vitin 2019, ekipi i PPNEA-s sëbashku me përfaqesues nga stafi i ADZM Korçë, organizuan censusin e pelikanit në Parkun kombëtar të Prespës, me qëllim konfirmimin e vendeve të qëndrimit dhe ushqimit në këtë anë të liqeneve. Ky census u organzua përgjatë periudhës qershor-korrik 2019 prej ekipit të përbashkët të PPNEA dhe ADZM Korçë, dhe si rezultat u numëruan rreth 300 individë të pelikanit kaçurrel dhe atij të bardhë.

© Zydjon Vorpsi

Një fillim i ri për PPNEA-n në Prespë – Hapja e zyrës tonë lokale

Cveta Trajçe, Koordinatore e Zyrës Lokale

Të jesh i pranishëm dhe gjithmonë afër zonës ku punon është një aset tepër i vlefshëm për punën dhe vizionin e PPNEA-s.

Angazhimi i hershëm i PPNEA-s në Prespë dhe kontributi i saj historik për shpalljen e Parkut Kombëtar të Prespës, nuk mund të reflektohej më mirë sesa me hapjen e një zyre të përhershme lokale në Dolna Gorica (Goricë e Vogël). Kjo prani e konsoliduar në Prespë dëshmon seriozitetin dhe dëshirën tonë për të vazhduar punën në këtë rajon të mrekullueshëm. Në kuadër të projektit "Përforcimi i ruajtjes së natyrës nën udhëheqjen e organizatave në basenin ndërkufitar të Prespës", njësoj si partnerët e rrjetit PrespaNet, MES dhe SPP, hapja e zyrës lokale të PPNEA-s dëshmon synimin tonë të qartë për rritjen e pranisë në Prespë dhe angazhimin afatgjatë për ruajtjen dhe mbrojtjen e natyrës.

Gjatë vitit 2018, PPNEA e rriti praninë në zonë me emërimin e një përfaqësuese lokale, e cila menaxhon dhe koordinon aktivitetet në terren, në të njejtjën kohë duke punuar për përforcimin e marrëdhënieve me banorët vendas dhe bashkëpunimin me menaxherët e zonave të mbrojtura apo institucionet lokale. Duke përcjellë informacione në lidhje me projektin dhe punën e PPNEA-s, koordinatorja jonë përgatiti terrenin për ngritjen e zyrës lokale, e cila u realizua në vitin 2019. Identifikimi i një godine e cila do të shërbente për ngritjen e zyrës lokale ka qenë një sfidë më vete. Por, bashkëpunimi i ngushtë me Bashkinë Pustec rezultoi në një ofertë tepër dashamirëse për përdorimin dhe restaurimin e godinës së braktisur të kopshtit të fëmijëve në Dolna Gorica (Goricë e Vogël), një ndërtesë tepër e dashur për komunitetin lokal. Brenda një kohe tepër të shkurtër PPNEA investoi intensivisht në këtë ndërtesë, duke e kthyer në një ambient funksional për stafin e saj dhe miqësor për të gjithë vizitorët. Zyra jonë lokale në Prespë e kurorëzon punën e deritanishme të kryer nga PPNEA në zonë.

Ky ambient i ri, përtej punës së përditshme të organizatës tonë, do të mirëpresë aktivitete të ndryshme me fëmijët dhe të rinjtë e zonës, si dhe do të vendoset në dispozicion të komunitetit lokal për mbledhje apo diskutime të ndryshme për çështjet e ruajtjes së natyrës. Zyra jonë do të punojë intensivisht për rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimin e fëmijëve mbi rëndësinë e mbrojtjes së vlerave natyrore të rajonit, promovimin e vlerave kulturore dhe zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm në Prespë. Nëpërmjet kësaj prezence të vazhdueshme në zonën e Prespës, PPNEA i ofron çdokujt një mundësi për tu angazhuar në çështjet e ruajtjes së natyrës, duke rritur në këtë mënyrë interesin e komunitetit lokal për çështjet me rëndësi në Prespë. Zyra lokale në Prespë funksionon sipas një plani vjetor pune, i cili menaxhohet nga Cveta, Koordinatorja jonë lokale, që me dashamirësi mirëpret këdo që do të mësojë më tepër rreth punës së PrespaNet dhe PPNEA-s. Nëpërmjet kësaj zyre të re, PPNEA vjen më afër Prespës dhe bëhet akoma më e dashur për të.

© PPNEA

Parku Natyror Korab Koritnik

© PPNEA

Puna Jonë në Parkun Natyror Korab-Koritnik

Olsion Lama, Menaxher i Projekteve

Zona malore Korab-Koritnik është një hapësirë tepër e pasur për sa i përket biodiversitetit. Brenda saj gjenden një numër tejet i lartë bimësh të rralla e endemike, apo lloje të shumta të faunës. Për shkak të këtyre vlerave të spikatura të biodiversitetit, në 21 dhjetor 2011, kjo zonë u shpall si Park Natyror, kategoria e IV-t e Zonave të Mbrojtura, sipas Unionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN).

Parku Natyror Korab-Koritnik është pjesë e një zone ndërkufitare e cila ndahet me Parkun Kombëtar të Mavrovës e Malet e Sharrit në Maqedoninë e Veriut, si dhe me Parkun Kombëtar të Sharrit në Kosovë, që lidhet nëpërmjet një bio-korridori. Malet e Sharrit në pjesën e Maqedonisë së Veriut ende nuk gëzojnë status mbrojtjeje edhe pse prej disa vitesh po punohet për shpalljen e kësaj zone si Park Kombëtar.

Kjo zonë ndërkufitare, për shkak të vlerave të larta natyrore, luan një rol të rëndësishëm edhe në ekonominë vendase duke e ndihmuar komunitetin lokal me burime si lëndë druri, dru zjarri apo nënprodukte pylli, siç janë bimët mjekësore, frutat e pyllit, kërpudhat, etj. Presioni mbi këto burimë natyrore ka vazhduar duke u rritur, deri sa kohët e fundit po shfrytëzohen edhe zonat më të thella, duke sjellë dëmtimin e pakthyeshëm të shumë habitateve.

Në mënyrë që të promovohet përdorimi i qëndrueshëm i këtyre burimeve dhe të rritet vëmendja ndaj problematikave të tjera mjedisore në zonë, gjatë vitit 2019 janë zbatuar njëkohësisht dy projekte si nga PPNEA në Shqipëri, MES në Maqedoninë e Veriut, po ashtu dhe nga FINCH në Kosovë.

Këto projekte janë financuar nga DBU dhe GIZ nëpërmjet fondacionit EuroNatur, i cila ka ofruar një mbështetje tepër të madhe në realizimin e tyre. Projekti i financuar nga DBU, i cili perfundoi me sukses në fund të vitit 2019, titullohej: **Ruajtja e natyrës përgjatë brezit të gjelbër në Ballkan: Analizimi i kërcënimeve, zhvillimi i zgjidhjeve dhe rritja e kapaciteteve në rajonin Sharr / Šar Planina / Korab-Koritnik.** Nga ana tjetër, projekti i financuar nga GIZ, i cili është ende në fazë zbatimi, titullohet: **Forcimi i Grupeve Lokale të Veprimit si aktorë për mbrojtjen e biodiversitetit në zonën e Sharr / Šar Planina / Korab-Koritnik, e cila ndahet ndërmjet Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës.**

Ruajtja e natyrës përgjatë brezit të gjelbër në Ballkan: Analizimi i kërcënimeve, zhvillimi i zgjidhjeve dhe rritja e kapaciteteve në rajonin Sharr / Šar Planina / Korab-Koritnik

Projekti në fjalë filloi në muajin janar të vitit 2019 dhe përfundoi me sukses në muajin dhjetor të të njejtit vit. Gjatë kësaj periudhe, u zhvilluan me sukses të gjitha aktivitetet e parashikuara me qëllim realizimin e objektivave të projektit, të cilat ishin:

· Hartimi i pesë projekt-propozimeve që adresojnë problematikat mbi ruajtjen e natyrës dhe promovojnë përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore;

· Rritja e kapaciteteve të aktorëve lokal mbi zbatimin e projekt-propozimeve të hartuara prej tyre.

Gjatë vitit 2019 u identifikuan aktorët lokal, rreziqet kryesore që i kanosen zonës Korab-Koritnik, si dhe masat apo idetë inovatore për minimizimin apo parandalimin, ku është e mundur, të këtyre rreziqeve.

Gjatë kësaj faze, aktorët lokal u trajnuan mbi krijimin e aktiviteteve model mbi përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, duke marrë pjesë në vizitën studimore që u zhvillua në Gjermani, si dhe në dy seanca trajnimi të mbajtura në Shqipëri. Përveç këtyre, aktorët lokal u trajnuan edhe mbi metodologjinë "Open Standard" që përdoret në hartimin e një projekt-propozimi. Trajnimi ishte i organizuar në mënyrën "të mësuarit duke punuar", si pasojë gjatë zhvillimit të tij u hartuan edhe pesë projekt-propozimet të fokusuara në reduktimin e presionit mbi burimet natyore, duke promovuar përdorimin e qëndrueshëm të tyre. Këto projekt-propozime janë parashikuar të zbatohen gjatë vitit 2021.

Vizita studimore në Gjermani, Rhon Biosphere Reserve.

Gjatë prezantimit të shembujve më të mirë.

Forcimi i Grupeve Lokale të Veprimit si aktorë për mbrojtjen e biodiversitetit në zonën e Sharr / Šar Planina / Korab-Koritnik, e cila ndahet ndërmjet Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës

Gjatë vitit 2019 PPNEA ka punuar në zonën Korab-Koritnik edhe me një tjetër projekt, i cili ka si synim krijimin apo formimin e një grupi lokal veprimi (LAG). Zbatimi i këtij projekti ka filluar në korrik të vitit 2019 dhe është parashikuar të përfundojë në tetor të vitit 2020. Objektivat e tij janë:

· Themelimi i një grupi lokal veprimi (LAG) dhe forcimi i tij nëpërmjet rritjes së kapaciteteve apo njohurive, në mënyrë që të shndërrohet në një strukturë efektive në mbrojtjen e biodiversitetit dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

· Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit lokal dhe grupeve të interesit mbi vlerat e zonës dhe nevojën e tyre për tu mbrojtur.

Në mënyrë që këto objektiva të realizoheshin, gjatë vitit 2019 PPNEA zhvilloi disa aktivitete duke filluar me identifikimin e aktorëve lokal që mund të ishin pjesëtarët potencial të grupit lokal të veprimit (LAG). Akoma më tej, organizata jonë zhvilloi takime ndërmjet përfaqësuesve të tre Grupeve Lokale të Veprimit në Maqedoninë e Veriut, Kosovë dhe Shqipëri.

Takimi ndërmjet përfaqësuesve të FOSH LAG në Maqedoninë e Veriut dhe përfaqësuesve nga Shqipëria e Kosova.

Takimi ndërmjet administratës së Parkut Kombëtar të Mavrovës dhe stafit të AdZM Dibër e Kukës.

Identifikimi i pjesëtarëvë potencial të LAG - ut u realizua nëpërmjet takimeve në terren, si dhe duke përdorur një pyetësor vlerësimi, i cili u plotësua dhe analizua për të nxjerrë rezultatet. Një aktivitet mjaft i suksesshëm që u zhvillua në kuadër të këtij projekti është takimi i mbajtur në qytetin e Peshkopisë ndërmjet administratës së Parkut Kombëtar të Mavrovës dhe Agjencive Rajonale të Zonave të Mbrojtura (AdZM) Dibër dhe Kukës. Qëllimi i këtij takimi ishte shkëmbimi i eksperiencave dhe diskutimi mbi mënyrat e bashkëpunimit ndërmjet strukturave të menaxhimit të zonave në fjalë, duke organizuar monitorime të përbashkëta të jetës së egër, duke mos përjashtuar menaxhimin e problematikave të tjera që hasen në zonën ndërkufitare. Takimi në fjalë rezultoi i suksesshëm dhe frytdhënës, duke vendosur urat e bashkëpunimit ndërmjet këtyre strukturave menaxhuese. Ky takim u pasua nga të tjerë aktivitete të përbashkëta, ku përfaqësues të AdZM Dibër udhëtuan në Maqedoni e Veriut për të diskutuar mbi metodikën e monitorimit të dhisë së egër (Rupicapra rupicapra), e cila u pasua me realizimin e një ekspedite të përbashkët, ku u arrit të vrojtohet një popullatë e kësaj specie.

Gjatë monitorimit të përbashkët në Parkun Kombëtar të Mavrovës.

Gjatë festimit të ditës së brezit të gjelbërt.

Mirjan Topi, Ish - Menaxher i Projektit

Ishulli i Zvërnecit

© Xh. Xherri

Toka e Kështjellave dhe Shqiponjave: Menaxhimi i Integruar i Biodiversitetit në Zonat Bregdetare në Shqipëri

Xhemal Xherri, Menaxher i Projektit

Njerëzit brenda zonave me biodiversitet të lartë i mëshojnë specieve dhe ekosistemit përreth për sigurimin e ushqimit, ujit apo karburantit, si dhe për gjenerimin e të ardhurave. Zhvillimi i një turizmi të qëndrueshëm dhe miqësor ndaj natyrës mund të japë një kontribut të konsiderueshëm në përmirësimin e dinamikave social-ekonomike si në nivel lokal, ashtu edhe në nivel kombëtar.

Me mbështetjen e Critical Ecosystem Partnership Fund (CEPF), nëpërmjet investimeve në zonat me biodiversitet të lartë në basenin e Mesdheut, PPNEA ka zhvilluar aktivitete ekoturizmi, si dhe ka nxitur zhvillimin e jetesës së qëndrueshme me qëllim ruajtjen e tre zonave kyç për biodiversitetin (KBA) në Shqipërinë jugore, si:

· Peizazhi i Mbrojtur Vjosë – Nartë;

· Parku Kombëtar i butrintit – Gjiri i Sarandës;

· Parku Kombëtar Detar Sazan – Karaburun.

Në vitin 2019 PPNEA filloi implementimin e projektit "CEPF-108570 – Toka e Kështjellave dhe Shqiponjave: Menaxhimi i Integruar i Biodiversitetit në Zonat Bregdetare në Shqipëri", i cili mbështetet në Direktivën Strategjike nr.1 të CEPF: "Mbështetja e shoqërisë civile për angazhimin e grupeve të interesit në zhvillimin e qasjeve të integruara për ruajtjen e biodiversitetit në zonat bregdetare".

Aktivitetet me karakter ndërgjegjësues kanë qenë ndër kryesoret e implementuara në kuadër të këtij projekti. Ne kemi filluar punën për menaxhimin e website-it, www.naturetouralbania.info, i cili gjendet tashmë me një format të ri, më tepër interaktiv e tërheqës. Ideja themelore, përtej mirëmbajtjes, përqëndrohet në ridizenjimin e kësaj platforme në një mënyrë e cila do të jetë më tepër frytdhënëse për promovimin dhe zhvillimin turizmit natyror në zonë. Qëllimi kryesor është që kjo platformë t'i shërbejë si turistëve ashtu edhe komunitetit lokal. Kjo platformë online është duke promovuar turizmin e qëndrueshëm në secilën nga zonat kyç për biodiversitetin.

Akoma më tej, në kuadër të këtij projekti u prodhua një kalendar interaktiv, i cili u shpërnda në të dy zonat në fokus, si në Peizazhin e Mbrojtur Vjosë-Nartë, ashtu edhe në Parkun Kombëtar të Butrintit. Në përmbajtjen e kalendarit u theksua rëndësia e biodiversitetit dhe vlerave kulturore të të dy KBA-ve. Numri total i kalendarëve të prodhuar e të shpërndarë në të dy zonat e projektit ishte 2000, ku 1000 ju ofruan komunitetit të Butrintit, ndërsa 1000 të tjera u ndanë në Nartë.

Promovimi i festave lokale të cilat theksojnë vlerat natyrore dhe kulturore është gjithashtu një nga prioritetet kyç të PPNEA-s. Të shtunën e fundit të muajit shtator, me mbështetjen e Bashkisë së Vlorës, u organizua Festivali i Verës në Peizazhin e Mbrojtur Vjosë-Nartë. Në këtë aktivitet morën pjesë rreth 15 punishte vere nga zona të ndryshme të Shqipërisë, të cilat konkuruan për çmimin e verës më të mirë nga një juri e përbërë prej një grupi somelierësh. Akoma më tej, gjatë këtij aktiviteti, anëtarë të komunitetit lokal përgatitën ushqim me bazë produktet e detit, të cilat e bënë këtë festival akoma edhe më tërheqës.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte promovimi i vlerave natyrore e kulturore të Peizazhit të Mbrojtur Vjosë-Nartë, si dhe zhvillimi i dinamikave social-ekonomike të zonës. Përgjatë implementimit të projektit, PPNEA ndihmoi organizatat lokale në iniciativat e tyre modeste, siç ishte projekti "Ne riciklojmë".

Nxënës të shkollave 9-vjeçare mblodhën së bashku materiale të përdorura prej plastike dhe qelqi, me qëllim riciklimin e tyre në objekte funksionale e inovative. Kjo iniciativë inspiruese, i angazhoi me dëshirë nxënësit, duke bërë që edhe shkolla të tjera të fillonin implementimin e të tilla projekteve.

Mbështetja e bizneseve lokale dhe drejtimi i tyre në aktivitete të zhvillimit të qëndrueshëm u filluan me sukses pëgjatë vitit 2019. Dy sipërmarrje të qëndrueshme, një për secilën Zonë Kyç për Biodiversitetin, filluan përgatitjet për hedhjen në treg të produkteve të tyre. Në zonën e Parkut Kombëtar të Butrintit, projekti do të risjellë në jetë fabrikën e vjetër të prodhimit të reçelit. Për vite me rradhë, qyteti i Sarandës është njohur për prodhimin e llojeve tepër cilësore të reçelit në "Fabrikën e Recelit Sarandë".

Projekti ynë ka kontaktuar disa prej ish-punonjësve të kësaj fabrike, të cilët u treguan entuziastë për të filluar përsëri aktivitetin me suportin tonë. Në Peizazhin e Mbrojtur Vjosë-Nartë, në zonën tjetër kyç për biodiversitetin, projekti është duke punuar për të themeluar eko-biznese me fokus prodhimin e glikove dhe shurupeve. Deri më tani, lista e produkteve është përfunduar, ndërsa etiketat janë në proces finalizimi. Të dy këto eko - biznese do të gjenerojnë vende pune për komunitetet lokale, si dhe do të krijojnë mundësi të tjera për ripërtëritjen e dinamikave social-ekonomike të zonave ku do të ushtrojnë aktivitetin.

Zyra e Turizmit në Peizazhin e Mbrojtur Vjosë-Nartë, e ndërtuar në vitin 2015 nga PPNEA, është funksionale përgjatë të gjithë sezonit turistik. Një oficer lokal është punësuar për t'i ardhur në ndihmë turistëve, si dhe për të mirëmbajtur këtë infrastrukturë në zemër të peizazhit të mbrojtur. Kjo zyrë modeste, e vendosur në një pozicion tepër të favorshëm përgjatë rrugës kryesore Vlorë-Nartë-Zvërnec, i shërben njëkohësisht si turistëve, duke i ofruar informacion mbi biznese, atraksione të veçanta apo guida, po ashtu edhe sipërmarrësve të zonës, duke i reklamuar bizneset e tyre të qëndrueshme e miqësore ndaj natyrës. Mbrojtja e integritetit ekologjik të KBA-ve është një prioritet kyç i PPNEA-s. Që prej vitit 2018, Peizazhi i Mbrojtur Vjosë-Nartë, po kërcënohet prej investimeve "Gri", të cilat do të shkaktojnë një impakt tepër të lartë në tjetërsimin e habitatit dhe avifaunës në zonë.

Këto projekte përfshijnë ndërtimin e një aeroporti si dhe resorte masive turizmi. Të tilla investime, si në fazën e ndërtimit, ashtu në fazën operacionale, do të krijojnë shqetësime të vazhdueshme, të cilat do tjetërsojnë integritetin ekologjik të zonës. Përballë këtyre planeve, PPNEA nuk ka qëndruar duarkryq, por ka lobuar në mënyrë intensive, si në nivel kombëtar edhe në atë ndërkombëtar për anulimin e të tilla projekteve, të cilat kërcënojnë biodiversitetin dhe integritetin ekologjik të zonës. Pjesëmarrja në takime, si dhe lobime në nivele të ndryshme, kanë ndihmuar në ruajtjen e deritanishme të integritetit ekologjik të Peizazhit të Mbrojtur Vjosë-Nartë. Ne shpresojmë që puna jonë të pengojë të tilla investime, deri në anulimin e tyre në të ardhmen.

Roland Lleshi, Ish - Menaxher i Projektit



Rezervati Natyror i Menaxhuar Pishë-Poro

© PPNEA

Hapja e Rrugës drejt Një Rrjeti të Qëndreshëm Natura 2000 në Shqipëri

Projekti në fjalë ka filluar në ditët e para të muajit tetor 2019. Megjithëse një projekt i ri, ne kemi pritshmëri të larta për ndërmarrjen e një pune me rëndësi në vlerësimin biologjik, sipas standarteve të Natura 2000, për pjesë specifike brenda Zonave të Mbrojtura në Shqipëri.

Ky projekt synon që të ndërmarrë një vlerësim të detajtuar të Peizazhit të Mbrojtur Vjosë - Nartë dhe Rezervatit Natyror të Menaxhuar Pishë-Poro, si një kompleks natyror i përbashkët në fushën e ruajtjes së natyrës. Vlerësimi do të kryhet bazuar në kriteret e rrjetit Natura 2000, duke iu referuar Direktivës së Habitateve e të Shpendëve, të cilat përfaqësojnë themelin e legjislacionit evropian mbi ruajtjen e natyrës. Kufijtë e zonës do të përcaktohen duke u mbështetur në një metodë eko-pjesëmarrëse, së bashku me identifikimin dhe hartëzimin e habitateve e të specieve të rëndësishme në nivel evropian. Të tilla vlerësime janë parakusht për Shqipërinë në plotësimin e standarteve mbi ruajtjen e natyrës, në kuadër të procesit të integrimit në BE.

Sabina Çano, Menaxhere e Projektit

Implementimi i këtij projekti do të shërbejë si një model për të ilustruar se si ruajtja e natyrës dhe aktivitetet njerëzore janë të ndërlidhura. Projekti konsideron si thelbësor përhapjen e njohurive shkencore dhe arritjen e një kuptueshmërie të qartë midis banorëve lokal se si ky status i ri mbrojtës mund të ndikojë aktivitetet e tyre të jetës së përditshme.

Projekti Hapja e Rrugës drejt një Rrjeti të Qëndrueshëm Natura 2000 në Shqipëri – Kompleksi Nartë-Pishë-Poro, ka ecur në gjurmët e projekteve të mëparshme vlerësuese lidhur me rrjetin Natura 2000, por nuk ka qenë i lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me to. Rëndësia e projekteve të implementuar më parë si rasti i NaturAL, i implementuar në vitet 2015-2019, i cili është përballur me vështirësi të shumëllojshme, që tashmë janë tejkaluar, duke hapur rrugën për projektet në vijimësi.

Skuadra e ekspertëve që janë angazhuar në implementimin e projektit NaturAL, do të përbëjnë bërthamën e ekspertëve edhe në këtë projekt. Peizazhi i Mbrojtur Vjosë-Nartë dhe Rezervuari i Menaxhuar Pishë-Poro, dy zonat e propozuara për vlerësim sipas standarteve të Natura 2000 nga projekti në fjalë, njihen si Zona të Rëndësishme për Shpendët që prej vitit 2013. Të dy këto zona gëzojnë status të mbrojtur sipas kritereve të Unionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN), përkatësisht kategoria V (Vjosë-Nartë) dhe IV (Pishë-Poro), si dhe ndodhen aktualisht nën administrimin e AKZM-së.

Akoma më tej, këto zona njihen për rëndësinë e tyre biologjike dhe larmishmërinë e pyjeve me pishë, lagunave detare, dunave me rërë, shkurreve, grykëderdhjet e lumenjve, etj. Me rëndësi, gjithashtu, janë vlerat kulturore dhe historike të të dy zonave, të cilat përmbajnë 11 fshatra, ku pjesë e popullsisë lokale janë edhe disa minoritete greke. Burimi kryesor i të ardhurave për këto zona sigurohet prej agrikulturës, turizmit, peshkimit, si dhe prodhimit të kripës. Perceptimi i komunitetit lokal mbi statusin e ri që zona mund të marrë nuk është i njëtrajtshëm, çfarë tregon për një mungesë kuptueshmërie lidhur me të. Për këtë arsye, një punë e vazhdueshme informimi dhe komunikimi është kthyer në bazë për implementimin e qëndrueshëm të projektit.

Në kuadër të këtij projekti janë identifikuar target grupet e mëposhtëm:

· Qeveria e Shqipërisë;
· Qeveritë Lokale;
· OJF-të e zonës;
· Universitetet;
· Bizneset; dhe
· Banorët lokal.

Aktivitetet e implementuara në vitin 2019 :

· U arrit të themelohej grupi i ekspertëve të cilët do të punojnë për implementimin e projektit. Gjatë takimeve është përcaktuar plani i punës, së bashku me detyrat përkatëse për secilin;
· Është rishikuar literatura në lidhje me zonën Nartë-Pishë-Poro, duke mbledhur të dhëna të rëndësishme të cilat do të pëdoren si referencë në kuadër të aktiviteteve të projektit;
· Është ndërmarrë vizita e grupit të ekspertëve në zonë;
· Janë vendosur kontakte të drejtpërdrejta me Administratën Rajonale të Zonave të Mbrojtura në Fier dhe Vlorë, si institucionet përgjegjëse për menaxhimin zonave ku do të implementohet projekti;
· Aktivitetet kryesore do të implementohen duke filluar nga viti 2020 deri në marsin e vitit 2021.

Ky projekt mbështetet financiarisht nga Bashkimi Evropian dhe Fondacioni EuroNatur.

Programet e Edukimit Natyror dhe Nismat Ndërgjegjësuese

Klaudja Koçi, Koordinatore e Programeve të Edukimit

Të punuarit me shkollat 9-vjeçare, organizimi i trajnimeve për mësuesit dhe zhvillimi i sesioneve të edukimit, si brenda mjediseve të shkollës ashtu edhe në natyrë, përbëjnë aktivitetet themelore të PPNEA-s në edukimin mjedisor për ruajtjen e natyrës. Të tilla programe bashkëshoqërojnë përpjekjet tona ruajtëse për specie të ndryshme apo edhe habitate.

PPNEA ka zhvilluar një kuadër të përgjithshëm konceptual lidhur me aktivitetet e edukimit, i cili funksionon si një dokument udhërrëfyes për hartimin e programeve duke u mbështetur në edukimin në natyrë, i cili i afron fëmijët me natyrën, si dhe i bën ata ta përjetojnë intensivisht këtë të fundit nëpërmjet ekskursioneve dhe lojërave.

PPNEA mbështetet në kontributin e mësuesve për organizimin e sesioneve të edukimit, duke i paraprirë nëpërmjet një metodologjie për trajnimin e mësuesve përpara implementimit të programeve të edukimit. Akoma më tej, është konsoliduar një bashkëpunim i ngushtë me rrjetet profesionale të mësuesve të biologjisë, me të cilët organizata jonë konsultoi kuadrin edukues dhe së bashku u planifikuan aktivitetet e edukimit.

Ne, i jemi tepër mirënjohës bashkëpunimit të palodhur të mësuesve në të gjithë rajonet e vendit, sidomos rrjeteve të mësuesve në rajonin Pukë-Mirditë dhe Korçë, të cilët e kanë përkrahur me pasion vizionin tonë për të integruar edukimin dhe lojërat në natyrë me lëndët e mësimore përgjatë vitit 2019. Gjithashtu, falenderojmë edhe Drejtoritë Arsimore Rajonale (DAR), si dhe Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) për suportin e treguar.

Pasqyra e aktiviteteve me fokus edukimin dhe ndërgjegjësimin për vitin 2019:

- **648 fëmijë** dhe nxënës të shkollave të mesme;
- **80 studentë** universiteti;
- **99 mësues;**
- **27 shkolla;**
- **35 sesione** në klasa;
- **5 evente në natyrë** (WMBD + SA festival + Munella + Nivica run); dhe
- **6 rajone** në Shqipëri.

Kiti edukues mbi rrëqebullin e Ballkanit, ose "BlxEduKit" është hartuar në mënyrë specifike për nxënësit nga klasa e parë në të gjashtë, me qëllim edukimin e tyre mbi këtë specie të rrezikuar në mënyrë kritike, habitatin e tij apo edhe prehun, duke mos përjashtuar ndikimin njerëzor. Programi në fjalë ka përfshirë një manual udhëzues për mësuesit, një prezantim në Power-point të ndjekur nga aktivitete në grup si brenda klasave ashtu edhe në natyrë, një libër edukativ "Historia e Shpresës së Rrëqebullit të Ballkanit", materiale mbështetëse për realizimin e punimeve me dorë, si edhe një poster 3D i rrëqebullit me qëllim lehtësimin e ilustrimit gjatë orëve të mësimit.
Ky program është zhvilluar me sukses në 16 shkolla të rajonit Pukë-Mirditë, ku sesionet e edukimit u pasuan nga një konkurs pikture i hapur për të gjithë nxënësit e shkollave 9-vjeçare në rajon. Pjesëmarrësit arritën të realizojnë piktura të jashtëzakonshme të rrëqebullit të Ballkanit, simbolit të këtij rajoni, të cilat morën pjesë në një konkurs të hapur në platformën Facebook. Fituesit u bashkuan në një ekspeditë në shtëpinë e rrëqebullit të Ballkanit, në peizazhin e mrekullueshëm malor të malit të Zepës dhe atij të Munellës. Ata lexuan poema, kënduan këngë, kundruan shpendë dhe morën pjesë në vendosjen e kamerave kurth. Këta shkencëtarë të vegjël, dashurinë dhe përkushtimin ndaj mbrojtjes së rrëqebullit të Ballkanit e shpërndanë te bashkëmoshatarët dhe familjet e tyre.

Grupi i mësuesve të trajnuar në rajonin e Pukës dhe Mirditës.

Grupi i mësuesve të trajnuar në rajonin e Pukës dhe Mirditës.

Aktivitetet edukuese mbi kalin e Qyqes kanë angazhuar fëmijë prej rajonit Tepelenë-Gjirokastër në aktivitete të ndryshme edukimi mjedisor me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e kalit të qyqes, shkabës së fundit folezuese në Shqipëri, dhe rreziqeve që i kanosen. Në fshatrat Nivicë e Progonat, të rrethuar prej maleve, fëmijë dhe studentë/e të rinj/reja kundruan shpendë dhe mësuan të identifikojnë specie të ndryshme, midis tyre edhe shkabën e mrekullueshme, kalin e qyqes.
Studentët e rinj e treguan dashamirësinë kundrejt kalit të qyqes duke marrë pjesë në aktivitetin "Gjiro Run- Vrapo për Kalin e Qyqes", një garë e organizuar në qytetin e Gjirokastrës, e cila simbolizoi vështirësitë me të cilat kjo specie e rrallë përballet gjatë shtegtimit nga Evropa në Afrikë e anasjelltas. Megjithatë, eventi më i madh me fokus rritjen e ndërgjegjësimit, ishte pjesëmarrja e organizuar e PPNEA-s në maratonën e Tiranës, me fushatën "Një Milje për Kalin e Qyqes".
Në 13 tetor 2019, më tepër se 100 pjesëmarrës vrapuan për këtë specie të rrezikuar në mënyrë kritike, kalin e qyqes. Mbështetësit e iniciativës vrapuan me bluzen e kalit të qyqes me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e kësaj shkabe dhe veprimet konkrete që duhen ndërmarrë për rimëkëmbjen e popullatës së saj. Një fushatë e tillë u implementua pothuajse nga të gjithë partnerët e projektit "Jetë e Re për Kalin e Qyqes", në 14 shtete të ndryshme.

Gjiro Run - Vrapo për Kalin e Qyqes.

2019 - Festimi i Ditës Ndërkombëtare për Shpendët Shtegtues

"Të ushqyerit e shpendit të vetëm në botë i cili pëlqen plastikën!"

Nën temën e Ditës Ndërkombëtare të Shpendëve Shtegtues për vitin 2019: "Mbro Shpendët: Bëhu zgjidhja për ndotjen nga plastika", PPNEA organizoi një iniciativë për pastrimin e një prej ligatinave më të rëndësishme në Shqipërinë Qendrore, Sektori Rinia-Fllakë, përgjatë rrugës së shtegtimit të Adriatikut, të cilës iu bashkuan 70 dashamirës të natyrës. PPNEA, së bashku me ISHMPUT Durrës, AdZM Durrës, CSDS Durrës, si dhe studentë nga Universiteti "Aleksandër Moisiu" dhe gjimnazi Manez, pastruan plazhin e pishat e zonës, duke praktikuar edhe kundrimin e shpendëve.

PPNEA, në kuadër të ndërgjegjësimit për ndotjen nga plastika, ka ndërtuar një strukturë metalike në formën e rosës me qëllim që aty të grumbullohen mbeturinat e mbledhura në ligatinën Sektori Rinia-Fllakë.
Kjo strukturë metalike ende vazhdon t'i bëjë përshtypje anëtarëve të komunitetit dhe vizitorëve të zonës, ajo gjithashtu vazhdon që të mbushet me plastikë gjatë gjithë kohës. Kjo platformë, jo vetëm është duke ndihmuar në mbledhjen e lehtë të plastikës, por edhe në rritjen e ndërgjegjësimit mbi ndikimin e plastikës te shpendët dhe specie të tjera. Kjo strukturë na kujton çdo ditë se sa e madhe është ndotja e shkaktuar prej plastikës në mjedis.

© PPNEA

© PPNEA

Programi Edukues "Të njohim bimët e rajonit tonë", iniciativë e PrespaNet mbi edukimin mjedisor për periudhën 2018-2019, përfshiu të gjitha shkollat në brendësi të Parkut Natyror të Prespës në Shqipëri. Ky rrugëtim edukativ përfshiu shkolla në Goricë të Vogël, Kallamas, Treni dhe Pustec. Programi përbëhej prej sesioneve të edukimit, si në klasa ashtu edhe në natyrë, me qëllim stimulimin e shqisave të fëmijëve si observimi, apo edhe nxitja e imagjinatës ndërkohë që i mësohej për bimët, biologjinë, ekologjinë dhe marrëdhëniet me kafshët. PrespaNet mbështetet së tepërmi në qasjet e "Edukimin Bazuar në Vendndodhje", në mënyrë që t'i ofrojë fëmijëve një mundësi për të mësuar mbi vlerat e jashtëzakonshme të biodiversitetit në Prespë, çfarë do të mundësojë lidhjen e hershme të fëmijëve me natyrën.

© PPNEA

Avancimi institucional i PPNEA-s për vitin 2019

Aleksandër Trajçe
Drejtor Ekzekutiv, PPNEA

Gjatë vitit 2019 PPNEA ka investuar në mënyrë të konsiderueshme lidhur me avancimin institucional të organizatës. Në kuadër të planifikimit strategjik, këtë vit PPNEA organizoi për të parën herë një staff retreat. Ky workshop i cili zgjati më tepër se dy ditë u organizua në zonën malore të Razmës, në datat 16-18 janar 2019. Gjatë këtij aktiviteti, stafi i PPNEA-s, nëpërmjet një lehtësuese të jashtme, përgatiti bashkarisht planin vjetor për vitin 2019, zhvilluan ushtrime të cilat forcojnë përkatësinë në grup, si dhe diskutuan mbi konsolidimin e një strategjie operacionale afatgjatë për organizatën. Në këtë takim u identifikuan drejtimet strategjike të organizatës, si dhe u forcua shpirti i skuadrës drejt hartimit të një strategjie të re për dekadën që do të vijë. Viti 2019 dëshmoi finalizimin e Manualit të Politikave të Brendshme të Organizatës, një dokument strategjik, i cili filloi në vitin 2018 dhe u përmbyll nëpërmjet aprovimit nga Bordi Drejtues në muajin janar 2019. Ky manual përfshin të gjitha rregullat e brendshme për aktivitetin e zyrës, personelin, burimet njerëzore, konsideratat etike në vendin e punës, etj.

Bordi Drejtues i PPNEA-s mbajti 5 takime gjatë vitit 2019, një numër ndjeshëm më i lartë nga vitet e mëparshme. Këto takime u organizuan, përkatësisht, në muajin janar, qershor, korrik, tetor, nëntor dhe dhjetor. Gjatë këtyre takimeve u diskutuan çështje që lidhen me mbarëvajtjen e aktivitetit të organizatës, ku u adresuan problematika të lindura kohë pas kohe. Bordi i Drejtorëve, gjatë vitit 2019, u angazhua në mënyrë aktive për çështjet institucionale, duke e bërë më të lehtë dhe efiçente punën e përditshme të stafit. Nëpërmjet një granti institucional të ofruar nga EuroNatur, partneri afatgjatë i PPNEA-s, ne arritëm të përfitojmë mbështetje ligjore për avancimin institucional të organizatës. Një zyrë ligjore u kontraktua nga PPNEA për adresimin e çështjeve ligjore, ofrimin e ndihmës në përmirësimin e dokumenteve ligjore e strategjike, si dhe përfaqësimin e PPNEA-s në të gjitha çështjet, si ato mjedisore, ashtu edhe në ato institucionale. PPNEA përdor metodologji të standartizuara për matjen e progresit.

Në terma të progresimit të programeve/ projekteve, iniciativa të rëndësishme të PPNEA-s ndjekin Standartet e Hapura për Praktikat e Konservimit (http://cmp-openstandards.org/), të cilat përfaqësojnë një kuadër të adaptueshëm pune, të përdorur prej qeverive lokale apo OJF-ve në të gjithë botën me qëllim ruajtjen e florës dhe faunës në mënyrë sistematike dhe bashkëpunuese. Në terma të progresit institucional, PPNEA përdor metodologjinë CSTT (https://s3.amazonaws.com › cepf-documents › CivilSocietyTrackingTool-EN), një kornizë pune që synon të monitorojë kapacitetet e organizatave të shoqërisë civile për të planifikuar, implementuar dhe vlerësuar në mënyrë efektive veprimet për ruajtjen e biodiversitetit. Që prej vitit 2017, PPNEA është duke ndjekur rregullisht parimet e CSTT nëpërmjet organizimit të workshop-eve pjesëmarrëse me prezencën e të gjithë stafit të organizatës. Stafi ynë, në muajin janar 2019, bashkarisht ndërmori vlerësimin vjetor duke u bazuar në CSTT. Kjo praktikë e kthyer në traditë për PPNEA-n ka treguar se mund të ofrojë një ndihmë të jashtëzakonshme për analizimin e çështjeve problematike brenda organizatës, matjen e progresit, si dhe identifikimin e fushave ku pritet përmirësim. Një zhvillim madhor në kuadër të avancimit institucional për vitin 2019 ishte fillimi i procedurës për hapjen e një zyre lokale në Parkun Kombëtar të Prespës. Duke mbajtur parasysh angazhimin afatgjatë të PPNEA-s në këtë zonë, si dhe ndihmën që kjo prezencë e përhershme do të jepte në koordinimin me pjesëtarët e tjerë të rrjetit PrespaNet (MES dhe SPP), u vendos që të progresohej me një plan konkret drejt themelimit të një zyre lokale në këtë rajon. Pas një vlerësimi të hollësishëm, ish-shkolla fillore në fshatin Goricë e Vogël u vendos që të shndërrohej në zyrën tonë lokale të ardhshme. Nëpërmjet ndihmës së konsiderueshme të Bashkisë Pustec, si dhe financimit bujar të PONT dhe Jensen Foundation, u ndërmorën hapa konkretë drejt hapjes së zyrës sonë lokale. Rikonstruktimi i ndërtesës avancoi vrullshëm me qëllim që zyra të ishte gati në muajin shkurt 2020, për të festuar si 20-vjetorin e Deklaratës së Përbashkët të Parkut Ndërkufitar të Prespës, ashtu edhe 10-vjetorin e nënshkrimit të marrëveshjes për të.

Anëtarë të stafit tonë morën pjesë në trajnime tejet të rëndësishme gjatë vitit 2019, si pjesë e qëllimit institucional për të ngritur kapacitetet e brendshme në implementimin efiçent të aktiviteteve të projekteve, si dhe për t'i shërbyer avancimit të përgjithshëm të misionit dhe objektivave të organizatës. Drejtori Ekzekutiv i PPNEA-s përfundoi me sukses kursin 1 - vjeçar mbi lidershipin në ruajtjen e natyrës, të organizuar nga Akademia e fondacionit MAVA. Të gjithë anëtarët e stafit morën pjesë në trajnime mbi planifikimin e projekteve dhe atë strategjik gjatë Staff retreat-it të organizuar në muajin janar. Të tjera trajnime të specializuara përfshinë rritjen e kapaciteteve mbi identifikimin e habitateve dhe monitorimin duke ndjekur udhëzimet e Natura 2000, të organizuara në kuadër të projektit të Prespës, nën drejtimin e ekspertëve nga Greqia. Një trajnim i financuar nga GIZ mbi mediat dhe komunikimin u ndoq me sukses nga oficeri ynë i komunikimit. Dy anëtarë të stafit tonë morën pjesë në udhëtime studimore, si në Gjermani, ashtu edhe në Slloveni, me qëllim përfitimin e eksperiencës mbi zhvillimin e qëndrueshëm dhe menaxhimin efiçent të zonave të mbrojtura. Oficerja jonë lokale në Prespë u trajnua mbi principet e guidave në natyrë. Së fundmi, anëtarë të stafit tonë kanë mundësi të konsultohen me ED për mentorimin mbi çështje të ndryshme rreth punës së përditshme dhe avancimit profesional. Eksperienca dhe aftësitë e fituara në Akademinë e MAVA-s po përçohen në punën e përditshme të PPNEA-s, duke i shërbyer punës së stafit dhe përmirësimit të përgjithshëm të menaxhimit të organizatës.

Pasqyrat Financiare

Shpenzime



Personeli
Furnitura, nëntrajtime dhe shërbime për aktivitete e projekteve
Shpenzime udhëtimesh për punë në terren

Eljona Pujo, Financiere

121,113 Euro: Shpenzime për personelin

98,680 Euro: Shpenzime për furnitura, nëntrajtime dhe shërbime për aktivitete e projekte

28,891 Euro: Shpenzime udhëtimesh për punë në terren

Të ardhura



Grante
Kontrata shërbimi specialistë

261,008 Euro: Të ardhura në total

247,608 Euro: Grante

13,400 Euro: Kontrata shërbimi nga specialistë

Falenderime

Falenderojmë të gjithë partnerët dhe bashkëpunëtorët tanë, të cilët kanë përkrahur iniciativat tona dhe me dashamirësi kanë kontribuar në mbrojtje të mjedisit natyror në Shqipëri.

Partnerë Ndërkombëtar

euronatur
BirdLife International – Europe and Central Asia
BirdLife International
MAVA Fondation pour la Nature
mnt
Critical Ecosystem Partnership Fund
european greenbelt
BSPB
IUCN
Aage V. Jensen Charity Foundation
ERA years
CAT Specialist Group
CMS
NGO Finch Kosova
Bird Protection and Study Society of Serbia
Egyptian Vulture New LIFE
Hrvatsko društvo za zaštitu ptica i prirode
Ορνιθολογική Hellenic Ornithological Society
A.G. Leventis Foundation
Four Paws
BIOM Udruga / Association
KORA
Young Researchers of Serbia – Voluntary Service of Serbia
Society for the Protection of Prespa – For Man and Nature
Македонско еколошко друштво
MOm
Naše ptice
NORD University
DBU Deutsche Bundesstiftung Umwelt
Vtop

Partnerë Kombëtar

Partnerë Lokal